



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 107

10 korrik

2013

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MPPT dhe MB
nr.3985/4, datë 24.6.2013

Mbi procedurat e kontrollit në transportin rrugor të mallrave të
rrezikshme.....

4691

UDHËZIM
Nr. 3985/4, datë 24.6.2013

MBI PROCEDURAT E KONTROLLIT NË TRANSPORTIN RRUGOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME^{1 2}

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 39 pikat 5 dhe 6, të nenit 45 pikat 2 dhe 3 dhe të nenit 63 të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012 “Për transportet e mallrave të rrezikshme”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

KREU I

1. Qëllimi, fusha e zbatimit dhe përkufizimet

1.1 Udhëzimi do të zbatohet për kontrollet e kryera nga personat e autorizuar për kontrollin në rrugë të mallrave të rrezikshme me mjete të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe mjete të regjistruara në një shtet tjetër, palë kontraktuese ose jo në Marrëveshjen Europiane të Transportit Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme.

1.2 Udhëzimi do të zbatohet edhe për kontrollet në mjediset e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në transportin e mallrave të rrezikshme.

1.3 Udhëzimi nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme:

a) me mjete që i përkasin ose janë nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe forcave të armatosura të shteteve të tjetra në përputhje me marrëveshjen/et në fuqi;

b) brenda perimetrit të një zone të mbyllur, ku mallrat mund të prodhohen, trajtohen përpunohen, ruhen, sistemohen apo transferohen në hapësirën e brendshme.

c) kur janë në përputhje me dispozitat përjashtuese të ADR-së.

1.4 Për qëllime të këtij udhëzimi do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

a) “ADR” nënkupton anekset A dhe B të Marrëveshjes Europiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme, të rishikuar ose të ribotuar herë pas here;

b) “Direktiva për kontrollin e mallrave të rrezikshme” nënkupton direktivën nr. 95/50/EC e Këshillit të 24 shtatorit 2008 “Mbi procedurat uniforme për kontrollet në transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë”, me amendime të herëpashershme;

c) “Kategoria e rrezikut” nënkupton kategorinë e shkëlqes të klasifikuar në përputhje me nivelin e rrezikut të përshkruar në anekset I dhe II të direktivës 95/50/EC dhe/ose anekset II dhe III të këtij udhëzimi.

ç) “Kontroll” nënkupton çdo kontroll, inspektim, verifikim ose formalitet të kryer nga organet përgjegjëse në rrugë, mjediset e subjektit dhe pikat e kalimit të kufirit, për arsye të sigurisë që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme;

¹ Ky ligj është përafuar plotësisht me direktivën e Këshillit nr. 95/50/EC e 6 tetorit 1995 “Mbi procedurat uniforme për kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme”. Numri i CELRX 311995L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 249, datë 17.10.1995, faqe 35.

² Direktivën e Komisionit nr. 2004/112/EC e 13 dhjetorit 2004 që adapton progresin teknik të direktivës së Këshillit nr. 95/50/EC e 6 tetorit 1995 “Mbi procedurat uniforme për kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme”. Numri i CELRX 32004L0112. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 367, datë 14.12.2004, faqe 23-28



d) “Ligji për transportin e mallrave të rrezikshme” nënkupton ligjin nr. 118/2012, datë 13.12.2012, i cili ka për qëllim rritjen e sigurisë në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme;

dh) “Mallra të rrezikshme” nënkupton ato substanca ose artikuj, transporti me rrugë i të cilëve është i ndaluar ose i autorizuar vetëm në rrethana të caktuar nga ADR-ja;

e) “Mjet” nënkupton çdo mjet motorik të destinuar për përdorimin në rrugë, nëse komplet ose jo komplet, i cili ka të paktën katër rrota dhe një shpejtuesi të caktuar që e kalon 25 km/orë, së bashku me rimorkion e tij, me përjashtim të mjeteve, të cilat udhëtojnë mbi shina, të traktorëve bujqësorë dhe pyjorë dhe/ose makineritë e lëvizshme;

ë) “Njësi transporti” nënkupton një mjet motorik pa rimorkio bashkëlidhur, ose një kombinim të përbërë prej një mjete motorik dhe një rimorkio bashkëlidhur;

f) “Person i autorizuar për kontrollin në rrugë” nënkupton personin ose grupin e personave të autorizuar nga organet e kontrollit në rrugë, sipas nenit 12 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 30 të ligjit nr. 10 433 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 7 të ligjit nr. 7986 “Për inspektoratin shtetëror të punës”;

g) “Pjesëmarrës” nënkupton personin ose subjektin e përfshirë në transportin e mallrave të rrezikshme dhe i lidhur me veprimtarinë e ngarkimit, shkarkimit, paketimit dhe mbushjes dhe përfshin dërguesin, transportuesin, marrësin, ngarkuesin, mbushësin, paketuesin, shkarkuesin, operatorin e cisternës-transferueshme ose kontejnerit-cisternës, e vagonit-cisternë, drejtuesin e mjetit, këshilltarin e sigurisë, organin inspektues;

h) “Transport” nënkupton operacionin e transportit, të kryer me anë të një mjete, plotësisht ose pjesërisht në rrugët publike, i drejtuar plotësisht ose pjesërisht brenda Shqipërisë, në të cilët përfshihen veprimtaritë e ngarkimit, shkarkimit, ambalazhimit dhe mbushjes, por nuk përfshin transportin e kryer plotësisht brenda perimetrit të një zone të mbyllur, e cila nuk është e hapur për publikun.

KREU II

2. Caktimi i personave të autorizuar për kontroll në rrugë dhe në ndërmarrje

2.1 Personat e autorizuar për kontroll janë personat e autorizuar ose të caktuar sipas nenit 12 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 30 të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 7 të ligjit nr. 7986, datë 13.9.1995 “Për inspektoratin shtetëror të punës”.

2.2. Autoritetet e përmendura në pikën 2.1 të këtij neni caktojnë personat e autorizuar për kontroll për qëllime të zbatimit të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012 brenda zonës përkatëse të përgjegjësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.3 Personi i autorizuar për kontroll është i pajisur me një autorizim/dokument nga autoriteti i tij, që e ka autorizuar apo caktuar.

2.4 Gjatë ushtrimit të detyrës, personi i autorizuar për kontroll, me kërkesë të subjektit ndaj të cilit ushtrohet kontroll, paraqet autorizimin/dokumentin identifikues.

3. Kontrollat në rrugë dhe lista e shkeljeve

3.1 Me qëllim lehtësimin e kontrolleve në transportin rrugor do të përdoren dokumente të njëjta me ato që përdorin shtetet anëtare të BE-së, si dokument që tregon rezultatet e kontrollit sipas aneksit I ose lista e kontrollit sipas aneksit II të këtij udhëzimi. Një kopje e listës së kontrollit ose dokumentit që tregon rezultatin e kontrollit i plotësuar nga personi i autorizuar për kontroll i jepet drejtuesit të mjetit, i cili e paraqet me kërkesën e personit të autorizuar për kontroll, për thjeshtimin e shmangien e kontrolleve të mëtejshme.

3.2 Kontrollat në rrugë janë të rastësishme e duhet të shtrihen në pjesën më të madhe të rrjetit rrugor.

3.3 Kontrollat kryhen në vende të caktuara, ku lejohen mjetet, që kanë kryer shkelje të dispozitave të ADR-së apo ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012, për t'u sjellë në përputhje me dispozitat e ligjeve të përmendura ose, nëse personi i autorizuar/caktuar që kryen kontrollin e gjykon të përshtatshme t'i ndalojë në vend ose në një vend të caktuar për këtë qëllim pa shkaktuar rrezik të sigurisë.

3.4 Kur është e përshtatshme dhe me kusht, që kjo nuk përbën rrezik për sigurinë, mostrat/kampionet e mallrave të rrezikshme të transportuara mund të merren për ekzaminim në laboratorët e akredituar dhe/ose notifikuar nga personi i autorizuar për kontroll dhe/ose individë të kualifikuar për këtë qëllim. Për marrjen e mostrave/kampioneve plotësohet një procesverbal sipas aneksit VII të këtij udhëzimi, një kopje e të cilit i dorëzohet subjektit që u kontrollua.

4. Ndalimi i mjetit në rrugë dhe në pikat e kalimit të kufirit

4.1 Pavarësisht dënimeve të tjera për të cilat ndalohen, mjetet për sa u përket, të cilëve një ose më shumë shkelje të rregullave në transportin e mallrave të rrezikshme, në veçanti shkeljet sipas aneksit II të këtij udhëzimi, ndalohen menjëherë ose në vend ose në vendin e caktuar, për këtë qëllim, nga personat e autorizuar që kryejnë kontrollin dhe i kërkohet drejtuesit të mjetit për ta sjellë në konformitet para vijimit të operacionit ose merren masa të tjera të përshtatshme:

a) për shkarkimin e mallrave nga mjeti që nuk është në konformitet me ADR-në dhe të ngarkohet në një mjet tjetër në konformitet me ADR-në;

b) për rimorkimin e mjetit në një oficinë larg qendrave të banuara, duke u shoqëruar nga organet e kontrollit në rrugë, në varësi të rrethanave ose kërkesave të sigurisë.

4.2 Mjeti që kryen rimorkimin në rastin e shkronjës "c" të pikës 4.1 të kësaj pike duhet, gjithashtu, të jetë në konformitet me ADR-në për llojin e mallrave që janë duke u transportuar.

4.3 Në lehtësim të punës së kontrollorëve, rritjes së përgjegjësisë së tyre gjatë ushtrimit të kontrollit, në aneksin V, bashkëlidhur këtij udhëzimi, janë identifikuar pjesëmarrësit në transportin e mallrave të rrezikshme, shkeljet e pjesëmarrësve me përshkrimin e shkeljes sipas ADR-së dhe kategoria e nivelit të rrezikut sipas aneksit II të direktivës 95/50EC.

4.4 Në pikat e kalimit të kufirit, organet doganore, të kufirit dhe ato të DPSHTRR-së, nëse konstatojnë shkelje të një mjeti të regjistruar në një shtet tjetër sipas ADR-së ose anekseve II dhe V të këtij udhëzimi, ndalojnë hyrjen e mjetit në territorin e Shqipërisë dhe e lejojnë atë të lëvizë vetëm pasi rezulton që shkeljet janë rregulluar, ose merren masa të përshtatshme në varësi të rrethanave sipas pikës 4.1.

5. Kontrollat në mjediset e subjektit

5.1 Kontrolli kryhet në mjediset e subjektit në rastin kur:

a) shërben si një masë parandaluese për rrezikun në rrugë;

b) shkeljet janë regjistruar gjatë kontrollit në anë të rrugës;

c) shkeljet janë regjistruar të përsëritura nga kontrollat në anë të rrugës sipas shkronjës "b" të këtij neni.

5.2 Kur një ose më shumë shkelje, në mënyrë të veçantë, ato të përmendura në aneksin V të këtij udhëzimi, janë vendosur për sa i përket transportit të mallrave të rrezikshme me rrugë, transporti do të silltet në konformitet para se mjeti të largohet nga mjedisi i subjektit ku ndodhet ose do të merren masa për ndalimin e mjetit deri në rregullimin e të metave.

5.3 Kontrolli në mjediset e subjektit do të ushtrohet në bazë të kërkesave të përmendura në aneksin VI të këtij udhëzimi. Nëse gjatë kontrollit në mjediset e subjektit konstatohen shkelje në lidhje me mallrat e rrezikshme, organi kontrollues vendos dënimin e duhur dhe një kopje të dokumentit sipas aneksit I ia dorëzon subjektit.



5.4 Personi i autorizuar për kontroll në mjediset e ndërmarrjes ka të drejtë të futet në çdo vend ku dispozitat e transportit rrugor zbatohen, ose i cili përdoret për qëllime që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme me rrugë dhe/ose siguron pajisje të transportueshme me presion dhe përfshin hetimin brenda, inspektimin dhe kërkimin:

- a) e çdo veprimtarie, instalimi, procesi, procedure, materiali ose pune në këtë vend;
- b) e çdo pajisjeje të transportueshme me presion ose të gjithë mallrat e rrezikshme ose regjistrimet në lidhje me to, për të vlerësuar nëse dispozitat e transportit të mallrave të rrezikshme janë plotësuar dhe, për këtë qëllim, marrin me vete dhe përdorin ndonjë pajisje ose material që e konsiderojnë të nevojshëm;
- c) e të gjithë dokumentacionit në *hard-copy* apo në pajisjet elektronike.

5.5 Personat e autorizuar për kontroll dhe/ose individë të kualifikuar, mund të marrin me vete:

- a) mostra/kampionë të mallrave të rrezikshme për analiza laboratorike, në mënyrë që të mos rrezikohet siguria. Pas marrjes së mostrave/kampionëve për prova laboratorike, personat e autorizuar për kontroll dhe/ose individë të kualifikuar, plotësojnë procesverbalin sipas modelit në aneksin VII të këtij udhëzimi, një kopje të të cilit ia japin subjektit që u kontrollua;
- b) materiale apo pajisje të ndryshme për prova;
- c) dokumente në formë *hard-copy* apo në formë elektronike etj.

6. Shkëmbimi i informacionit

6.1 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shkëmben informacion me shtetet e tjera për sa u përket shkeljeve të transportuesve të regjistruar në një shtet tjetër dhe u dërgon informacion shteteve të tjera për transportuesit e saj të regjistruar në Shqipëri.

6.2 Për shkeljet e kryera nga transportuesit e huaj të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, Policia Rrugore dhe organet e tjera të kontrollit të ngarkuar me ligjin nr. 118/2012, datë 13.12.2012, dërgojnë informacion në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (PSHTRR), brenda 45 ditëve nga konstatimi, e cila e grumbullon atë dhe më pas ia përcjell ministrisë.

6.3 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shkeljet e regjistruara për transportin e huaj, të regjistruar në një shtet tjetër, i plotëson sipas modelit të aneksit IV të këtij udhëzimi, i cili quhet raporti vjetor dhe e përcjell çdo vit kalendarik jo më vonë se muaji prill i vitit në vazhdim.

6.4 Raporti përmban:

- a) volumin e përcaktuar apo të vlerësuar të mallrave të rrezikshme të transportuara (në tonë të transportuara ose në tonë/kilometra);
- b) numrin e kontrolleve të kryera;
- c) numrin e mjeteve të kontrolluara, të klasifikuara sipas shtetit të regjistrimit të mjetit (mjetet e regjistruar në vend dhe në shtete të tjera);
- ç) numrin dhe llojet e shkeljeve të regjistruara, në përputhje me kategorinë e rrezikut;
- d) numrin dhe llojet e masave ndëshkuese të vendosura.

KREU III

7. Dokumentet shoqëruese në bordin e mjetit

7.1 Një njësi transporti e ngarkuar me mallrat rrezikshme nuk duhet në asnjë rast të përfshijë më shumë se një rimorkio (ose gjysmërimorkio).

7.2 Përveç dokumenteve të kërkuara sipas akteve ligjore e nënligjore të tjera, për mjetin, mallin dhe drejtuesin e mjetit, dokumentet që duhet të mbarten në mjetin që transporton mallra të rrezikshme subjekt për kontroll, janë si vijon:

- a) certifikata e trajnimit të drejtuesit sipas seksionit 8.2.1 të ADR-së, kur është e aplikueshme;

b) certifikata e miratimit ADR të mjetit, sipas seksionit 9.1.3 të ADR-së për çdo njësi transporti ose element të saj, kur është e nevojshme;

c) instruksionin me shkrim në rast aksidenti, sipas seksionit 5.4.3 të ADR-së;

ç) dokumenti/dokumentet e transportit (fletudhëtimi i ngarkesës) të përshkruar në seksionin 5.4.1 të ADR-së dhe kur duhet edhe certifikatën e kontejnerit të madh ose certifikatën e paketimit sipas seksionit 5.4.2 të ADR-së. Në aneksin VIII është dhënë përmbajtja e dokumentit/dokumenteve të disa transporteve kryesore;

d) dokumentet e identifikimit të drejtuesve të mjetit, të cilët duhet të përmbajnë fotografi;

dh) një kopje e autorizimit, kombëtar/bilateral/multilateral të lëshuar nga organi përkatës administrativ, sipas rastit, në përputhje me nenet 23, 26 dhe 27 të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012 dhe me shkronjat “c” ose “d” të pikës 5.4.1.2.1 ose 5.4.1.2.3.3 të ADR-së me kushtet bashkëlidhur dokumenteve të transportit. Gjuha e plotësimit të dokumentit të transportit, sipas ADR-së, është gjuha zyrtare e vendit të specicionimit dhe, gjithashtu, nëse kjo gjuhë nuk është në anglisht, frëngjisht ose gjermanisht, dokumenti hartohet në anglisht, frëngjisht ose gjermanisht;

e) certifikata e inspektimit të cisternës për mjetet-cisternë, cisternat fikse, cisternat e transferueshme, cisternat e çmontueshme e kontejnerët-cisternë.

8. Përmbajtja dhe kërkesat për dokumentacionin

8.1 Certifikata e trajnimit të drejtuesit, i kërkohet:

a) drejtuesit të mjeteve për transportin në paketa, me përjashtim të operacioneve të transportit që përftohen në pikën 1.1.3.6;

b) drejtuesit të mjeteve që transportojnë mallra të rrezikshëm në cisterna fikse ose të çmontueshme me një kapacitet që i kalon 1 m³, mjetet bateria me kapacitet të përgjithshëm, që i kalon 1 m³, kontejnerët-cisternë, cisternat portative ose MEGC me kapacitet që i kalon 3 m³.

c) drejtuesit të mjeteve që transportojnë lëndë plasëse (LP);

d) drejtuesit të mjeteve që transportojnë materiale radioaktive.

8.2 Mjetet që duhet të kenë certifikatën e miratimit ADR:

a) mjetet-cisternë, cisternat e çmontueshme, cisternat portabile (të transferueshme), KGESH (MEGC) dhe mjetet bateri;

b) mjetet që mbartin kontejnerët-cisternë;

c) mjetet që transportojnë eksplozivë;

ç) tërheqësi rrugor i caktuar, kryesisht ose ekskluzivisht, për të tërhequr cilindro prej mjeteve rrugore pa shtytjen e vet (rimorkio ose gjysmërimorkio).

8.3 Konformiteti i mjeteve EX/II, EX/III, FL, OX dhe AT me dispozitat e pjesës 9 do të sigurohet nga certifikata e miratimit ADR (certifikata e miratimit ADR) të lëshuar nga organi përgjegjës në vendin e regjistrimit të mjetit.

8.4 Certifikata e miratimit ADR të mjetit nuk i referohet cisternës, e cila ka certifikatat e veta të miratimit të tipit dhe inspektimet fillestare, periodike, të ndërmjetme, të tyre, të shënuara në pllakën treguese.

8.5 Mjetet që transportojnë paketa apo kuti në kontejnerë, nuk kërkojnë certifikatën e miratimit ADR, përveçse transportin e lëndëve plasëse (LP).

9. Instruksionet me shkrim

9.1 Si një ndihmë gjatë një situatë emergjente për një aksident që mund të ndodhë ose lind gjatë transportit, instruksionet me shkrim në formatin e specifikuar sipas pikës 5.4.3.4 të ADR-së ose pikës më poshtë do të mbahet në kabinën e mjetit në gjendje gatishmërie.

9.2 Instruksionet me shkrim do të sigurohen nga transportuesi tek ekuipazhi i mjetit në gjuhën(ët) që çdo anëtar mund të lexojë dhe të kuptojë para nisjes së udhëtimit. Transportuesi do të garantojë që çdo anëtar i ekuipazhit të mjetit t'i kuptojë dhe t'i zbatojë siç duhet instruksionet.



9.3 Para nisjes së udhëtimit, anëtarët e ekuipazhit të mjetit do të informohen vetë për ngarkesën e mallrave të rrezikshme dhe konsultojnë instruksionet me shkrim për detajet e veprimit që duhet të ndërmerret në rast aksidenti ose emergjence.

9.4 Instruksionet me shkrim duhet të korrespondojnë me modelin 4-faqësh në ADR ose në aneksin IX të këtij udhëzimi, në lidhje me formën dhe përmbajtjen.

10. Instruksionet me shkrim në përputhje me ADR-në

10.1 Në rastin e një aksidenti apo emergjence që mund të ndodhë ose të lindë gjatë transportit, anëtarët e ekuipazhit të mjetit ndërmarrin veprimet që vijojnë ku siguria dhe zbatueshmëria për ta bërë këtë:

- Aplikoni sistemin e frenimit, ndaloni motorin dhe izoloni baterinë me aktivizimin e çelësit kryesor kur është e aplikueshme;

- Shmangni burimet e ndezjes, në veçanti, mos pini duhan ose ndizni ndonjë pajisje elektrike;

- Informoni shërbimet e përshtatshme të emergjencës, duke i dhënë sa më shumë informacion rreth incidentit ose aksidentit dhe substancat e mundshme të përfshira;

- Vishni veshjet paralajmëruese dhe vendosni trekëndëshin e paralajmërimit të përshtatshëm;

- Ruani dokumentet e transportit të gatshme për punonjësit e emergjencës në mbërritje;

- Mos ecni mbi ose mos prekni substancat e derdhura dhe shmangni thithjen e gazrave, tymit, pluhurit dhe avujve të mbetur në anën nga e cila fryn era;

- Kur është e përshtatshme dhe e sigurt për të bërë këtë, përdorni aparatet për fikjen e zjarrit për të shuar zjarret e vogla/fillestare në goma, frena dhe pjesën e motorit;

- Anëtarët e ekuipazhit të mjetit nuk do të veprojnë kundër zjarreve në kompartimentet e ngarkesave;

- Kur është e përshtatshme dhe e sigurt për të bërë këtë, përdorni pajisjet në bord për të parandaluar rrjedhjet në mjedisin ujqor ose sistemin e kanalizimit dhe të përmbajë derdhjet;

- Largohuni nga vendi i aksidentit apo i emergjencës, këshilloni personat e tjerë për të lëvizur dhe ndiqni këshillat e shërbimeve të emergjencës;

- Hiqni veshjet mbrojtëse dhe pajisjet e kontaminuara të përdorura dhe të vendosen në mënyrë më të rregullt të sigurt.

11. Pajisjet për mbrojtje të përgjithshme dhe personale për kryerjen e veprimeve të përgjithshme dhe veprimet specifike që duhen kryer në raste emergjente dhe rreziku në bordin e mjetit sipas 8.1.5 të ARD-së

11.1 Njësia e transportit duhet të ketë në bordin e mjetit pajisjet e mëposhtme:

- për çdo mjet, bllokues rrote me madhësi të përshtatur për peshën maksimale të mjetit dhe për diametrin e rrotës;

- dy sinjale, trekëndësha paralajmëruese;

- solucion (lëng) për larjen e syve, për numrat e etiketave të rrezikut 1, 1.4, 1.5, 1.6, 2.1, 2.2 dhe 2.3;

- pajisje për (shuarjen) fikjen e zjarrit në përputhje me pikën 81.4 të ADR-së ose aneksin X të këtij udhëzimi; dhe

Për çdo anëtar të ekuipazhit të mjetit:

- veshje paralajmëruese (p.sh. siç përshkruhet në standardin EN 471);

- aparat i transferueshëm ndriçimi;

- një palë doreza mbrojtëse; dhe

- mbrojtëset e syve (syze mbrojtëse).

11.2 Pajisje shtesë të nevojshme për disa klasa:

- për çdo anëtar të ekuipazhit të mjetit duhet të mbahet në mjet maska e shpëtimit në raste emergjente për numrat e etiketave të rrezikut 2.3 ose 6.1;

- lopata;

- mbulesë për largimin e lagështirës apo bllokimin e rrjedhjes;
 - kolektor mbledhës,
- të kërkuara vetëm për numrat e etiketave të rrezikut, të ngurta ose të lëngëta 3, 4.1, 4.3, 8 ose 9.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
SOKOL OLLDASHI**

**MINISTRI I BRENDSHËM
FLAMUR NOKA**



ANEKSI I
DOKUMENTI I REZULTATEVE TË KONTROLLIT DHE I PAGESËS

Organi i kontrollit¹: _____

Njoftimi sipas nenit 57 të ligjit nr. 118, datë 13.12.2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”

Njoftimi i pagesës fikse

Identifikimi i pjesëmarrësit:

Emri i pjesëmarrësit:.....
.....

Adresa e pjesëmarrësit:.....
.....

Vendi i kontrollit rrugor:.....

Data e kontrollit në rrugë:..... Numri i regjistrimit të mjetit.....

Pretendohet që Ju, si pjesëmarrës në transportin e mallrave të rrezikshme me mjetin, me numrin e regjistrimit të mësipërm, në vendin e mësipërm dhe në datën e mësipërme, keni kryer shkeljen/et e treguara më poshtë, tek e cila legjislacioni i treguar më sipër zbatohet.

Ju duhet të paguani pa vonesë shumën e përgjithshme:lekë për sa u përket shkeljes/ve së pretenduar, tek cila duhet të shoqërohet me këto njoftime, tek inspektori me emrin e emërtuar më poshtë.

| | | | | | |
|----------------------|--|--|--|--|--|
| Aneksi V | po <input type="checkbox"/> | jo <input type="checkbox"/> | Aneksi VI | po <input type="checkbox"/> | jo <input type="checkbox"/> |
| Shkelja/shkeljet nr. | <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> |

Përshkrimi i transportit:.....
.....

Vërejtje:.....
.....

Akuza për shkeljen/et e pretenduar nuk krijohet nëse shuma e mësipërme paguhet te inspektori në këtë njoftim brenda 21 ditëve nga data e mëposhtme.

E nënshkruar:..... data:
Inspektori i kontrollit [emri i organit të kontrollit i vendosur këtu, brenda këtyre kllapave]

¹ Emërtimi i organit të kontrollit

ANEKSI II
LISTA E KONTROLLIT

1. Vendi i kontrollit
 2. Data.....
 3. Koha.....
 4. Shenja kombëtare dhe numri i regjistrimit (targa).....
 5. Shenja kombëtare e rimorkios/gjysmërimorkios dhe numri i regjistrimit (targa).....
 6. Subjekti që kryhen transportin/adresa.....
 7. Drejtuesi/drejtuesi tjetër.....
 8. Dërguesi, adresa e vendit të ngarkimit ^{(1) (2)}.....
 9. Marrësi, adresa e vendit të shkarkimit ^{(1) (2)}.....
 10. Sasia e përgjithshme (maksimale) e mallrave të rrezikshme për njësinë e transportit.....
 11. Kufizimi sasior i kapërcyer
- ADR, pika 1.1.3.6 po jo
12. Mënyra e transportit i papaketuar pako cisternë
- Dokumentet në bordin e mjetit**
13. Dokumentet e transportit u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 14. Instruksioni me shkrim u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 15. Autorizim bilat/multilat./kombëtar u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 16. Certif. e miratimit të mjetit u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 17. Certif. e trajnimit drejtuesit u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
- Operacioni i transportit**
18. Mallra të autorizuar për transport u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 19. Mjetet e autorizuar për transp. e mall. u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 20. Dispozita në lidhje me mënyrën e transp (bulk, paketa, cisternë) u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 21. Ndalimi i ngarkimit të përzierë u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 22. Ngarkimi, sigurimi i ngarkesës dhe trajtimi ⁽³⁾ u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 23. Rrjedh. e mall. ose dëmtimi paket. ⁽³⁾ u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 24. Shënimi UN i ambalazhit/shënimi i Cisternës (ADR, 6) ^{(2) (3)} u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 25. Shënimi i paketimit (d.m.th. nr. UN) dhe etiketimi (ADR, 5.2) ⁽²⁾ u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 26. Cisterna/paneli i mjetit (ADR 5.3.1) u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
 27. Mjeti/shënjimi njësisë së transportit (paneli portokalli, temperaturë të rritur) u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet (ADR 5.3.2-3)



Pajisjet në bord

28. Pajisja e sigurisë për qëllimin e përgjithshëm të specifikuar në ADR u inspektua
 shkelja u konstatua nuk zbatohet
29. Pajisjet në përputhje me mallrat që transportohen u inspektua shkelja u konstatua
 nuk zbatohet
30. Pajisje të tjera të specifikuara në instruksionet me shkrim u inspektua shkelja u
konstatua nuk zbatohet
31. Fiksja/et e zjarrit u inspektua shkelja u konstatua nuk zbatohet
39. Kategoria e rrezikut më serioze për shkeljet e vendosura, nëse ka
 Kategoria I Kategoria II Kategoria III
40. Shënime.....
41. Organi përgjegjës/personi i autorizuar që ka kryer kontrollin ⁽⁴⁾.....

1. Të plotësohet vetëm për shkeljen përkatëse
2. Të dëshmohet sipas shenjave për operacionet e transportit në grup
3. Kontrolli i dëmtimeve të dukshme
4. Emërtimi i organit të kontrollit

ANEKSI III
PËRSHKRIMI I SHKELJEVE SIPAS KATEGORIVE TË RREZIKUT DHE VEPRIMET
QË NDËRMERREN NË LIDHJE ME KËTO SHKELJE

1. Kategoria e rrezikut I

Kategoria I e rrezikut janë shkeljet që rezultojnë me mungesë të përputhjes me dispozitat përkatëse të ADR-së duke krijuar aksidente me pasojë vdekjen, plagosje serioze të personit ose dëmtim të rëndësishëm të mjedisit. Në këto raste ndërmerret ndalim i menjëhershëm i mjetit dhe rregullimi i të metave.

Mungesat janë:

1. Mallrat e rrezikshme që transportohen janë të ndaluara për transport;
2. Rrjedhja e substancave të rrezikshme;
3. Transporti me mënyra të ndaluara ose me mjete të papërshtatshme për transport;
4. Transporti i hapur në një kontejner, i cili nuk është me strukturë rezistente;
5. Transporti në një mjet pa një certifikatë të përshtatshme të miratimit;
6. Mjeti nuk përputhet më me standardet e miratimit dhe paraqet një rrezikshmëri të menjëhershme (përndryshe shkon te kategoria e rrezikut II);
7. Ambalazh i paautorizuar përdoret;
8. Ambalazhi nuk është në përputhje me instruksionin e paketimit të aplikueshëm;
9. Dispozitat speciale për paketimin (ambalazhimin) e përzierë nuk janë në përputhje;
10. Rregullat kryesore për sigurimin dhe fiksimin e ngarkesës nuk janë në përputhje;
11. Rregullat për ngarkimin e përzier të paketave nuk janë në përputhje;
12. Niveli i lejuar i mbushjes së cisternave ose paketave nuk është në përputhje;
13. Dispozitat që kufizojnë sasinë që transportohen në një njësi transporti nuk përputhen;
14. Transporti i mallrave të rrezikshme pa një tregues të prezencës së tyre (d.m.th. dokumentet, shenjat (markimet) dhe etiketat në paketat, plakat dhe shenjat në mjet);
15. Transporti pa pllaka (panelet) dhe shenja në mjet;
16. Informacion në lidhje me substancat që transportohen për të lehtësuar përcaktimin e shkeljeve të kategorisë së rrezikut I (p.sh. numrin UN, emrin e përshtatshëm të ngarkesës, grupin e paketimit);
17. Drejtuesi i mjetit nuk zotëron certifikatën e trajnimit profesional;
18. Përdoret zjarr ose ndriçim, i pambrojtur;
19. Ndalimi në pirjen e duhanit nuk zbatohet.

2. Kategoria e rrezikut II

Kategoria II e rrezikut janë shkeljet që rezultojnë me mungesë të përputhjes me dispozitat përkatëse të ADR-së duke krijuar aksidente me pasojë plagosjen e personit ose dëmtime të mjedisit. Në këto raste merren masa të përshtatshme për ndreqjen e të metave në vendin e kontrollit, nëse është e mundur dhe e përshtatshme, por në përfundim lejon të paktën lëvizjen e mjetit.

Mungesat janë:

1. Njësia e transportit nuk përmban më shumë se një rimorkio/gjysmërimorkio;
2. Mjeti nuk përputhet më me standardet e miratimit, por nuk paraqet një rrezikshmëri të menjëhershme;
3. Mjeti nuk është i pajisur me fikëse zjarri në gjendje pune siç kërkohet; një fikëse zjarri mund të gjykohe në gjendje pune nëse vula dhe/ose data e përfundimit mungojnë; megjithatë, kjo nuk zbatohet nëse fiksja e zjarrit nuk është më në gjendje pune dukshëm, p.sh. matësi i presionit në 0;
4. Mjeti nuk mbart pajisjet e kërkuara në ADR ose në instruksionin me shkrim;
5. Datat e testit dhe inspektimit dhe periudhat e përdorimit të ambalazhit, IBCs ose ambalazhit të madh nuk janë në përputhje;



6. Paketat me ambalazhe të dëmtuara, IBCs ose ambalazhi i gjerë ose ambalazhi i dëmtuar, i papastër bosh janë duke u transportuar;

7. Transporti i mallrave të paketuara në një kontejner, i cili nuk është me strukturë rezistente;

8. Cisternat/kontejneri-cisternë (që përfshin edhe ato që janë bosh ose të papastër) nuk mbyllen siç duhet;

9. Transporti i ambalazhimit (paketimit) të kombinuar me një ambalazh të jashtëm, i cili nuk është i mbyllur siç duhet;

10. Etiketa, shënjime ose pllakata, jokorrekte;

11. Nuk ka instruksion me shkrim në përputhje me ADR-në, ose instruksionet me shkrim nuk janë të përshtatshme me mallrat që transportohen;

12. Mjeti nuk vëzhgohet ose parkohet siç duhet.

3. Kategoria III e rrezikut

Kategoria III e rrezikut janë shkeljet që rezultojnë me mungesë të përputhjes me dispozitat përkatëse, por që mbartin një nivel të ulët të rrezikut të plagosjes së personit dhe nuk ka nevojë për marrjen e masave të përshtatshme në anë të rrugës, por kontrolli mund të adresohet në një datë të mëvonshme në mjediset e subjektit apo ndërmarrjes.

Mungesat janë:

1. Përmasat e pllakateve ose germave të etiketave, shifrave ose simboleve në pllakata ose etiketa nuk përputhen me rregullat;

2. Informacioni në dokumentet e transportit përveçse në kategorinë e rrezikut I/(16) nuk është i disponueshëm;

3. Certifikata e trajnimit nuk është në bordin e mjetit, por mund të vërtetohet që ai e zotëron atë.

Shënim

Në rastin kur ka disa shkelje për njësinë e transportit, vetëm kategoritë e rrezikut më serioze (siç tregohet në artikullin 39 të aneksit II të këtij udhëzimi) do të aplikohet për qëllime raportimi sipas aneksit IV të këtij udhëzimi.

ANEKSI IV
MODELI STANDARD I MODELIT PËR RAPORTIN QË I DËRGOHET ORGANEVE
PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE PËR SHKELJET DHE DËNIMET

Vendi:..... Viti:.....

Kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme

| | | Vendi i regjistrimit të mjetit | | | Numri i përgjith. |
|---|---------------------------------|--------------------------------|---------------------------------|----------------|-------------------|
| | | Vendi i kontrollit | Shtete palë kontraktuese në ADR | Vende të treta | |
| Numri i njësive të transportit të kontrolluara mbi bazat e përmbajtjes së ngarkesës (dhe ADR) | | | | | |
| Numri i njësive të transportit që nuk janë në përputhje me AD-në | | | | | |
| Numri i njësive të transportit të ndaluara | | | | | |
| Numri i shkeljeve të shënuara në përputhje me kategorinë e rrezikut | Kategoria e rrezikut I | | | | |
| | Kategoria e rrezikut II | | | | |
| | Kategoria e rrezikut III | | | | |
| Numri i dënimeve të vendosura në përputhje me llojin e dënimit | Paralajmërim | | | | |
| | Gjobë | | | | |
| | Të tjera | | | | |

| | | |
|--|--------|--------------|
| Sasia e përgjithshme e llogaritur e mallrave të rrezikshme të transportuara me rrugë |t | ose.....t.km |
|--|--------|--------------|



ANEKSI V PËRDORIMI PRAKTIK I LISTËS SË KONTROLLIT PËR SHKELJET QË MUND TË NDODHIN

Në listën e kontrollit të paraqitur në aneksin II të këtij udhëzimi ose në aneksin I të direktivës 95/50/EC “*Mbi procedurat uniforme për kontrollet në transportin e mallrave të rrezikshme*” e 6 tetorit 1995, e ndryshuar me direktivën e Komisionit 2004/112/EC janë paraqitur në parim shkeljet e mundshme që mund të ndodhin. Kërkesat nga seksion 1 deri në 12 duhet detyrimisht të plotësohen nga organet e kontrollit në rrugë.

Lista e shkeljeve që mund të ndodhin, fillon nga seksioni 13 dhe përfundon në seksionin 31 të aneksit II të këtij udhëzimi ose të aneksit I të direktivës 95/50/EC.

Tabela e mëposhtme është ndarë në 6 kolona. Në kolonën e parë është numri serial që përcakton shkeljen. Kolona e dytë përmban përshkrimin e shkeljeve sipas ADR-së, të cilat shoqërohen me dispozitën përkatëse në këtë marrëveshje të formuluar në kolonën e katërt të tabelës.

Kolona e tretë, e cila emërtohet “kategoria e rrezikut” përbëhet nga dy linja. Linja e parë paraqet kategorinë e rrezikut të shprehur në aneksin II të direktivës 95/50/EC, ndërsa në linjën e dytë është paraqitur pozicioni që zë shkelja, në po këtë aneks.

Në kolonën e pestë jepen dispozitat e shkeljeve sipas ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012 “*Për transportin e mallrave të rrezikshme*” në përputhje me dispozitat e shkeljeve sipas ADR-së të shprehura në kolonën e dytë.

Në kolonën e gjashtë është identifikuar pjesëmarrësi/pjesëmarrësit që kanë kryer shkeljen/shkeljet.

Në tabelën që vijon, për çdo pjesëmarrës të transportit rrugor, jepet akronimi i tij.

IDENTIFIKIMI I PJESËMARRËSVE DHE AKRONIMET

| Shkronja | Pjesëmarrësi | Shkronja | Pjesëmarrësi |
|-----------|---------------|-----------|---|
| D | Dërguesi | Dr | Drejtuesi |
| T | Transportuesi | E | Ekui-pazhi i drejtimit (drejtuesi tjetër) |
| Mb | Mbushësi | KS | Këshilltari i sigurisë |
| N | Ngarkuesi | M | Marrësi |
| A | Ambalazhuesi | O | Operatori i kontejnerit-cisternës ose cisternës së transferueshme |
| Sh | Shkarkuesi | | |

IDENTIFIKIMI I SHKELJES

| Nr. | Përshkrimi i shkeljes sipas ADR-së | Kateg. e rrezik. sipas aneksit II të 95/50/EC | Shkeljet e dispozitave të ADR-së 2013 | Shkeljet e dispozitave të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012 neni/nenet | Pjesëmarrësi në transport |
|--|---|---|---------------------------------------|---|---------------------------|
| PËRDORIMI I LISTËS SË KONTROLLIT SIPAS DIREKTIVËS 95/50/EC E NDRYSHUAR ME DIREKTIVËN 2004/12/EC DHE PËRPUTHJA E SHKELJEVE ME ADR 2013 DHE LIGJIN NR. 118/2012, DATË 13.12.2012, SI DHE IDENTIFIKIMI I PJESËMARRËSVE PËR SHKELJE | | | | | |
| 13. DOKUMENTET E TRANSPORTIT | | | | | |
| 1 | Dokumentet e transportit të mallrave të rrezikshme nuk janë dhënë ose nuk janë në përputhje me ADR-në. | I 1.14 | 8.1.2.1 (a) dhe 5.4.1 | 14 | D |
| 2. | Transporti i mallrave të rrezikshme pa identifikuar mallrat e rrezikshme të transportuar me dokumentin/et e shoqërimit të mallit. | I 1.14 | 8.1.2.1 (a) dhe 5.4.1 | 14 | D |

| | | | | | |
|----|---|--------------------------|--------------|----|---|
| 3 | Dokumenti i transportit pa numrin e duhur të UN, emërtimin e duhur të dërgesës, grupin e transportit dhe disa informacione të tjera përkatëse. | I 1.14 | 5.4.1.1.1 | 14 | D |
| 4 | Dërgesa nuk jep kodin e klasifikimit, modelet e etiketave ose klasën, siç zbatohen. | III 3.2 | 5.4.1.1.1 c) | 14 | D |
| 5 | Transporti i mallrave me mjet, kontejner dhe/ose cisternë (nr.UN 3359) me trajtim tymosjeje pa dokumentet e shoqërimit të mallit sipas nënseksionit të përmendur në 5.5.2.4 të ADR-së. | I 1.16 | 5.5.2.4 | 14 | D |
| 6 | Transporti me automjete ose kontejnerë që janë subjekt i ftohjes apo i ajrit të kondicionuar me dhe nuk kanë qenë të ventiluar plotësisht para transportimit, pa dokumentet e transportit të lidhura me pikën 5.5.3.7 të ADR-së. | I 1.16 | 5.5.3.7 | 14 | D |
| 7 | Informacioni i kërkuar në dokumentin e transportit është i palexueshëm. | I 1.16 | 5.4.1.1.2 | 14 | D |
| 8 | Transportimi i mbetjeve që përmbajnë mallra të rrezikshme pa dokumentin e transportit sipas përmbajtjes së treguar në ADR 5.4.1.1.3. | III 3.2 | 5.4.1.1.3 | 14 | D |
| 9 | Transportimi i mallrave të rrezikshme në ambalazhe shpëtimi ose enë presioni, shpëtimi, pa shënimin e vendosur në dokumentacion të treguar në pikën 5.4.1.1.5 | III 3.2 | 5.4.1.1.5 | 14 | D |
| 10 | Mungesa apo keqpërdorimi i numrit dhe përshkrimi i paketave, kur është e aplikueshme. | I 1.16 | 5.4.1.1.1 e) | 14 | D |
| 11 | Për klasën 1, dokumenti i ngarkesës nuk tregon masën e përgjithshme neto, në kg, përmbajtjen e eksplozivit për çdo artikull ose substancë me numër UN të ndryshëm, dhe masën e përgjithshme neto, në kg për të gjithë artikujt dhe substancat e mbuluara nga dokumenti i transportit. | I 1.16 | 5.4.1.2.1 | 14 | D |
| 12 | Dokumenti i transportit nuk përmban informacionin për sasinë e përgjithshme dhe për secilën substancë ose artikull të mallrave të rrezikshme që mbart numrin UN të ndryshëm, emërtimin e duhur të dërgesës, ose kur është e përshtatshme me grupin e paketimit. | I 1.16 | 5.4.1.1.1 f) | 14 | D |
| 13 | Asnjë informacion nuk jepet në dokumentin e transportit për përmbajtjen e mjeteve bosh, të papastër. | III 3.2 | 5.4.1.1.6 | 14 | D |
| 14 | Dokumenti i transportit nuk përmban emrin dhe adresën e dërguesit/dërguesve. | | 5.4.1.1.1 g) | 14 | D |
| 15 | Dokumenti i transportit nuk përmban emrin dhe adresën e marrësit/marrësve | III 3.2 | 5.4.1.1.1 h) | 14 | D |



| | | | | | |
|----|--|--------------------------|--------------|----------------------|-----|
| 16 | Dokumenti i transportit nuk përmban ndonjë deklaratë në përputhje me dispozitat e veçanta të ndonjë marrëveshjeje të veçantë, kur është e aplikueshme. | III 3.2 | 5.4.1.1.1 i) | 14 | D |
| 17 | Dokumenti i transportit nuk përmban rastet kur është caktuar kodi i kufizimit të tunelit, kur është i aplikueshëm. | III 3.2 | 5.4.1.1.1 k) | 14 | D |
| 18 | Dokumenti nuk është i shkruar me gjuhë korrekte. | III 3.2 | 5.4.1.4 | 14 | D |
| 19 | Nuk ka dokumente në mjet në lidhje me devijimet e përkohshme të ADR-së. | I 1.16 | 4.3 1.5.1 | 14 | D |
| 20 | Nuk ka dokumente në mjet (autorizim ose autorizim i veçantë) në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme të autorizuar. | I 1.16 | | 14 23 26 27 | D/T |
| 21 | Mungesa e përmendjes së të qenit pjesë e një zinxhiri të transportit ajror ose detar në dokumentin e transportit. | III 3.2 | 5.4.1.1.7 | Neni 14 | D |
| 22 | Transporti i IBCs ose cisternave portabile pas datës së përfundimit të testit të fundit ose inspektimit periodik pa dokumentin miratues të përmendur në pikën 5.4.1.1.11 kur është e përshtatshme. | III 3.2 | 5.4.1.1.11 | 14 20 | D/O |
| 23 | Transporti në mjete-cisternë me shumë rezervuarë ose në një njësi transporti e përbërë me një rezervuar ose më shumë cisterna, pa treguar në dokumentin e ngarkimit materialin për çdo cisternë apo rezervuar. | I 1.16 | 5.4.1.1.13 | 14 15 | D/T |
| 24 | Transporti i materialeve të nxehta pa treguar në dërgesë përmendjen sipas pikës 5.4.1.1.14 të ADR-së. | III 3.2 | 5.4.1.1.14 | 14 | D |
| 25 | Transporti i substancave të stabilizuara me kontroll të temperaturës pa treguar në dokumentin e transportit emërtimin e duhur të dërgesës me përmbajtjen sipas pikës 5.4.1.1.15 të ADR-së. | III 3.2 | 5.4.1.1.15 | 14 | D |
| 26 | Transporti i substancave të cilat zbatohet dispozita speciale 640 e kapitullit 3.3 të ADR-së pa treguar në dokumentin e transportit përmbajtjen e pikës 5.4.1.1.16 të ADR-së. | I 1.16 | 5.4.1.1.16 | 14 | D |
| 27 | Transporti i substanca solide (të ngurta) pa treguar në dokumentin e transportit përmbajtjen e pikës 5.4.1.1.17 të ADR-së. | III 3.2 | 5.4.1.1.17 | 14 | D |
| 28 | Transporti i substancave të rrezikshme për mjedisin pa u treguar në dokumentin e transportit siç përmendet në pikën 5.4.1.1.18 të ADR-së. | III 3.2 | 5.4.1.1.18 | 14 | D |
| 29 | Transporti i mallrave të rrezikshme me mungesë të informacionit përkatës, të veçantë ose shtesë. | I 1.16 | 5.4.1 | 14 | D |

| | | | | | |
|----|--|--------------------|------------------------------|----|---|
| 30 | Transporti i mallrave të klasës 7, kur dokumenti i transportit nuk përmban informacion sipas pikës 5.4.1.2.5.1, siç është e aplikueshme. | I 1.16 | 5.4.1.2.5.1 | 14 | D |
| 31 | Dërguesi siguron në dokumentet e transportit një dëshmi në lidhje me veprimet nëse ka, dhe që duhet të merren nga transportuesi. Dëshmia është në gjuhën e kërkuar nga transportuesi ose autoritetet e interesuara dhe përfshin masat e përmendura në pikën 5.4.1.2.5.2 të ADR-së. | I 1.16 | 5.4.1.2.5.2 | 14 | D |
| 32 | Dokumentet e transportit nuk përmbajnë informacion korrekt (përveç sa më sipër). | III 3.2 | 5.4.1 | 14 | D |
| 33 | Transporti i mallrave të rrezikshme pa një certifikatë korresponduese e paketimit të kontejnerit kur transporti i paraprin një udhëtim nga deti. | III 3.2 | 5.4.2 | 14 | D |
| 34 | Certifikata e paketimit të kontejnerit apo mjetit nuk është në përputhje me pikën 5.4.2 të kodit IMDG. | III 3.2 | 5.4.2 | 14 | D |
| 35 | Miratim i ndërmjetëm (i përkohshëm) i lëshuar nga autoriteti përgjegjës do të përfshihet në dokumentet e dërgesës dhe që përmban një minimum informacioni për instruksionet e cisternave portabile dhe kushtet sipas të cilave substancat do të transportohen. | I 1.16 | 6.7.1.3 | 14 | D |
| 36 | Transporti i mostrave të produkteve kimike në të cilën zbatohet dispozita e veçantë 250 e pashoqëruar me një kopje autorizimi të transportit. | I 1.16 | | 14 | D |
| 37 | Transporti i objekteve të paambalazuara të klasës 1, sipas pikës 4.1.3.8 të ADR-së, pa një kopje autorizimi. | I 1.16 | 4.1.3.8 | 14 | D |
| 38 | Për klasën 1, substancat ose artikujt e caktuar me shënim p.s.n. (të paspecifikuar ndryshe) ose shënimin 0190 ose të paketuara konform instruksionit të paketimit P 101, mungon një kopje e miratimit (autorizimit) të autoritetit përgjegjës. | I 1.16 | 5.4.1.2.1 (c) 8.1.2.2 (c) | 14 | D |
| 39 | Për klasën 1, transporti i përbashkët në të njëjtin mjet i paketave që përmbajnë substanca ose artikuj të grupeve kompatibël B dhe D, mungon një kopje e autorizimit të lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kompartmentin e veçantë apo sistemin e kontrollit të mbrojtjes. | I 1.16 | 5.4.1.2.1 (d) 8.1.2.2 (c) | 14 | D |
| 40 | Transporti i materialeve vetëreaktive ose peroksideve organike sipas kushteve kur kërkohet autorizim dhe një kopje e këtij autorizimi bashkëlidhet në dokumentin e transportit që e përmend atë. | I 1.16 | 5.4.1.2.3.3 8.1.2.2 (c) | 14 | D |



| | | | | | |
|--|---|--------------------------|-----------------------------------|----------------|-------|
| 41 | Mos hipni në bordin e mjetit çdo anëtar të ekuipazhit pa mjete identifikuese (fotografi). | | 8.1.2.1 (d) | 35 | Dr/E |
| 42 | Transporti kur aplikohet dispozita e veçantë 363, në dokumentet e transportit mungojnë fjalët “Transporti sipas dispozitave të veçanta”, kur është e aplikueshme. | III 3.2 | 3.3 dispozita e veçantë 363 | 14 | D |
| 43 | Rezervë | | | | |
| 44 | Rezervë | | | | |
| 45 | Rezervë | | | | |
| 46 | Rezervë | | | | |
| 14. INSTRUKSIONI ME SHKRIM | | | | | |
| 47 | Instrukcionet me shkrim (dokumentacionet këshilluese) nuk janë dhënë ose nuk janë në përputhje në formë dhe përmbajtje me ADR. | II 2.11 | 8.1.2 5.4.3.4 | 15 | T |
| 48 | Instrukcionet me shkrim (dokumentacionet këshilluese) të papërshtatshme për mallrat që transportohen. | II 2.11 | 8.1.2 5.4.3 | 15 | T |
| 49 | Instrukcionet me shkrim (dokumentacionet këshilluese) nuk ndodhen në kabinën e drejtuesit të mjetit. | II 2.11 | 8.1.2 5.4.3.1 | 15 | T |
| 50 | Instrukcionet me shkrim (dokumentacionet këshilluese) nuk janë të shkruara në gjuhë korrekte nga dërguesi. | II 2.11 | 8.1.2 5.4.3.2 | 14 | D |
| 51 | Instrukcionet me shkrim (dokumentacionet këshilluese) e kërkuara nuk mbahen në gjendje gatishmërie në kabinën e mjetit. | II 2.11 | 5.4.3.1 8.1.2. | 39 | Dr |
| 52 | Rezervë | | | | |
| 53 | Rezervë | | | | |
| 15. AUTORIZIMI KOMBËTAR/BILATERAL/MULTILATERAL | | | | | |
| 54 | Mungesa e një kopje të tekstit kryesor të një autorizimi të veçantë dhe/ose të posaçëm për kryerjen e transportit, nëse është i aplikueshëm. | I 1.1 | Neni 4.3 Kapitulli 1.5 | 23 26 27 | D/T/M |
| 55 | Rezervë | | | | |
| 16. CERTIFIKATA E KONFORMITETIT TË MJETIT | | | | | |
| 56 | Transporti me një mjet pa certifikatën e përshtatshme të miratimit ADR. | I 1.5 | 8.1.2.2 9.1.3 | 37 | D/T |
| 57 | Rezervë | | | | |
| 17. CERTIFIKATA E TRJANIMIT PËR DREJTUESIT E MJETEVE DHE DETYRAT E DREJTUESIT TË MJETIT | | | | | |
| 58 | Drejtuesi i mjetit nuk zotëron një certifikatë të vlefshme trajnimi. | I 1.17 | 8.2.2.8 | 33 35 | D/T |
| 59 | Certifikata e trajnimit nuk është në bordin e mjetit, por mund të provohet se drejtuesi i mjetit e zotëron atë. | III 3.3 | 8.1.2.2 (b) 8.2.1 | 35 | Dr |
| 60 | Një udhëtar, përveç një anëtari të ekuipazhit të mjetit ka hipur në mjet. | III | 8.3 | 35 | Dr |

| | | | | | |
|--|--|--------------------------|---|--------------------|------------------|
| 61 | Drejtuesi nuk ndalon (fik) motorin gjatë operacionit të ngarkimit ose shkarkimit. | III | 8.3 | 36 | Dr |
| 62 | Drejtuesi nuk aplikon frenimin në parkim ndërsa mjete është i parkuar. | III | 8.3 | 36 | Dr |
| 63 | Mjeti nuk parkohet ose nuk vëzhgohet siç duhet. | II 2.12 | 8.3 | 36 | Dr |
| 64 | Kur pihet duhan gjatë operacioneve të trajtimit në afërsi të mjetit ose në mjet | I 1.19 | 8.3 | 36 17 19 | Dr/E/N/Mb/ Sh |
| 65 | Fener ndriçues i pambrojtur përdoret gjatë operacioneve të trajtimit në afërsi të mjetit ose në mjet. | I 1.18 | | 36 17 19 | Dr/E/N/Mb/ Sh |
| 66 | Mungesa në verifikimin e shkarkimit korrekt të mallrave të rrezikshme. | I 1.10 | 1.4.3.7 5.3 dhe 7.5.1.3 | 17 36 | Dr/Sh |
| 67 | Mungesa në largimin ose heqjen e mbetjeve të mallrave të rrezikshme pas shkarkimit. | II 2.6 | 7.5.8 | 36 17 | Dr/Sh |
| 68 | Rezervë | | | | |
| 69 | Rezervë | | | | |
| 18. MALLRAT E AUTORIZUAR PËR TRANSPORT | | | | | |
| 70 | Mallrat e rrezikshme që transportohen janë të ndaluara për transport. | I 1.1 | Tabelat A dhe B Pjesa 2 | 14 15 | D/T |
| 71 | Transporti i mallrave të rrezikshme në paketa, që nuk lejohen nga ADR-ja. | I 1.3 | Tabela A Kolona (8) | 7 | D/T |
| 72 | Transporti i mallrave të rrezikshme në cisterna që nuk lejohen nga ADR-ja. | I 1.3 | Tabela A Kolonat (10) dhe (12) | 7 9 | D/T |
| 73 | Transporti i mallrave të rrezikshme në sasi të mëdha e të hapura (bulk), që nuk lejohen nga ADR-ja. | I 1.3 | Tabela A Kolonat (10) | 7 | D/T |
| 74 | Shkelja e dispozitave që kufizojnë sasinë që transporton një njësi e transportit. | I 1.13 | 3.3 7.5.5 | 14 15 | D/T |
| 75 | Shkelja e dispozitave që kufizojnë sasinë që transporton një njësi e transportit e parashikuar në 1.1.3.6. | I 1.13 | 1.1.3.6 | 14 15 | D/T |
| 76 | Numri i paketave në ndonjë mjet apo kontejner, të mallrave rrezikshme në sasi të përjashtuese nuk i kalon 1000. | I 1.13 | 3.5.5 | 14 15 | D/T |
| 77 | Rezervë | | | | |
| 78 | Rezervë | | | | |
| 19. MJETET E AUTORIZIARA PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE | | | | | |
| 79 | Transporti i substancave dhe artikujve eksplozivë (1) më mjete, që nuk janë të konstruara për mallra të tilla. | I 1.5 | 7.2.4 9.1.1.2 9.1.3 | 12 9 | T |
| 80 | Transporti i mallrave më të rrezikshme në cisterna në mjete që nuk janë të autorizuara për mallra të tilla. | I 1.5 | Tabela A, Kolona 14 9.1.1.2 9.1.3 | 7 9 15 20 | T/O |
| 81 | Transporti i mallrave të rrezikshme në cisterna me kod të cisternës të paautorizuar për transportin e mallrave të tilla. | I 1.3 | Tabela A, Kolona 12 4.3 | 7 9 | T/O |
| 82 | Transporti i mallrave në paketa në një kontejner që nuk është konstruuar në mënyrë të përshtatshme. | II 2.7 | 7.1.4 | 7 | T/N |



| | | | | | |
|---|---|-------------------------|---|---------------------|---------|
| 83 | Mjeti, cisterna ose kontejneri nuk përputhen përgjithësisht me standardin e miratimit dhe paraqesin rrezik të menjëhershëm. | I 1.6 | 6.7 deri në 6.12 | 7 12 20 40 | T/O |
| 84 | Mjeti, cisterna ose kontejneri që transportojnë mallra të rrezikshme janë dëmtuar dhe paraqesin rrezik të menjëhershëm. | I 1.6 | 4.2 deri në 4.5 6.7 deri në 6.11 Pjesa 9 | 7 12 20 40 | T/O |
| 85 | Cisterna ose kontejneri-cisternë, që nuk mbyllet në mënyrë korrekte, duke lejuar rrjedhjen e përmbajtjes jashtë në mënyrë të pakontrolluar. | II 2.8 | 4.2 deri në 4.5 | 36 | Dr |
| 86 | Transporti i mallrave të rrezikshme, të granular në një kontejner që nuk është struktura në mënyrë të përshtatshme. | I 1.4 | 7.1.4 | 7 | T/N |
| 87 | Mjeti, cisterna apo kontejneri nuk përputhen plotësisht me standardin e miratimit, por nuk paraqesin rrezik imediat. | II 2.2 | 6.7 deri në 6.9 Pjesa 9 | 7 12 9 | T/O |
| 88 | Mjeti, cisterna apo kontejneri që transporton mallra të rrezikshme është dëmtuar, por nuk paraqet rrezik të menjëhershëm. | II 2.2 | 6.7 deri në 6.12 | 40 | T/D |
| 89 | Rezervë | | | | |
| 90 | Rezervë | | | | |
| 20. DISPOZITAT NË LIDHJE ME MËNYRËN E TRANSPORTIT (NË SASI TË MËDHA, PAKETA, CISTERNA) | | | | | |
| 91 | Transporti i mallrave të rrezikshme në paketa në një mjet të paautorizuar për të njëjtët artikuj. | I 1.3 | Tabela A, kolona (14) 7.2.4 9.1.1.2 | 12 | D/T |
| 92 | Transporti i mallrave të rrezikshme i kryer në një cisternë të paautorizuar për të njëjtët artikuj. | I 1.3 | Tabela A kolonat (10) dhe (12) 4.2.5.2 4.3 | 14 15 20 | D/T/O |
| 93 | Transporti i mallrave të rrezikshme në sasi të madhe në një kontejner të paautorizuar për të njëjtët artikuj. | I 1.3 | Tabela A kolonat (10) 7.3.2 | 14 15 | D/T |
| 94 | Përdor ambalazh/paketim të paautorizuar. | I 1.7 | Tabela A dhe 6.1 deri në 6.6 | 14 18 | D/A |
| 95 | Ambalazhi/paketimi nuk lejohet për materialin ose substancën. | I 1.7 | Tabela A, kolona (8) 4.1.4 | 7 | D/T/A/M |
| 96 | Ambalazhi/paketimi nuk përputhet me dispozitat e instruksionit të paketimit të aplikueshëm. | I 1.8 | 6.1 deri në 6.6 | 18 | A |
| 97 | Hapësira boshe e pamjaftueshme në ambalazhi/paketimi për transportin e lëngjeve. | I 1.12 | 4.1.1.4 | 19 | Mb |
| 98 | Paketat paketohen (ambalazhohen) në mënyrë të gabuar. | I 1.8 | 4.1.1.1 4.1.1.5 | 18 | A |
| 99 | Ambalazhi brendshëm i pamjaftueshëm rezistent për t'i rezistuar presionit të brendshëm ose valvulet e ajrimit nuk janë korrekte (të pasakta). | I 1.8 | 4.1.1.5 | 19 15 | Mb/T |

| | | | | | |
|---|---|-------------------------|---|----------------|----------|
| 100 | Mosrespektimi i datave të testimit dhe inspektimit dhe afatet e përdorimit të paketimit, ambalazheve të mëdha për lëndët e granuluara dhe ambalazhet e mëdha. | II 2.5 | 4.1 6.1 deri në 6.6 | 9 | D/N/Mb/T |
| 101 | Rezervë | | | | |
| 102 | Rezervë | | | | |
| 21. NDALIMI I NGARKESAVE TË PËRZIERA | | | | | |
| 103 | Mospërbushja e dispozitave të veçanta në ambalazhimin (paketimin) e përzier. | I 1.9 | Tabela A dhe 4.1.10 | 14 17 | D/N |
| 104 | Mospërbushja e dispozitave mbi ngarkesat e përzier të paketave. | I 1.11 | Kapitulli 7.5 | 14 17 | D/N |
| 105 | Ushqime ose artikuj të tjerë të konsumit ose ushqime për kafshët që nuk janë ngarkuar në përputhje me ADR-në. | I 1.11 | 7.5.4 | 14 17 | D/N |
| 106 | Rezervë | | | | |
| 22. NGARKIMI, SIGURIMI (FIKSIMI) I NGARKESËS DHE TRAJTIMI (MANIPULIMI) | | | | | |
| 107 | Shkelja e rregullave të fiksimit dhe vendosjes së ngarkesës. | I 1.10 | Kapitulli 7.5 | 14 17 | N/D |
| 108 | Shkelja e rregullave për nivelin e lejuar të mbushjes së cisternave. | I 12 | 4.2 deri në 4.7 6.7 deri në 6.12 | 19 15 | Mb/D |
| 109 | Shkelja e rregullave për nivelin e lejuar të mbushjes të ambalazhit/ ambalazheve (paketime). | I 1.12 | 4.1 6.1 deri në 6.6 | 17 15 | A/Mb/D |
| 110 | Cisternat/kontejnerët-cisternë (përfshirë dhe ato bosh e të ndotura) nuk janë mbyllur siç duhet. | II 2.8 | 1.4 4.2 4.3 | 19 15 | Mb/D |
| 111 | Transporti i një ambalazhimi të kombinuar me një ambalazhim të jashtëm që nuk është mbyllur siç duhet. | II 2.9 | 4.1.1.1 | 17 14 | A/D |
| 112 | Rezervë | | | | |
| 23. RRJEDHJA E MALLRAVE OSE DËMTIMI I PAKETAVE | | | | | |
| 113 | Rrjedhja e mallrave të rrezikshme nga paketat. | I 1.2 | 4.1.1.1 6.1 deri në 6.6 | 22 | T |
| 114 | Rrjedhja e mallrave të rrezikshme nga mjetet-cisternë ose kontejnerët-cisternë. | I 1.2 | 1.4 4.2 deri në 4.7 6.7 deri në 6.12 | 22 | T |
| 115 | Mjeti, cisterna ose kontejneri është i dëmtuar dhe paraqet një rrezik imediat. | I 1.6 | 4.2 deri në 4.7 6.7 deri në 6.12 | 22 | T |
| 116 | Paketat janë dëmtuar dhe paraqesin një rrezik imediat. | I 1.8 | 4.1 6.1 deri në 6.6 | 22 | T |
| 117 | Mjeti, cisterna ose kontejneri është dëmtuar dhe nuk paraqet një rrezik imediat. | II 2.2 | 4.2 deri në 4.7 | 22 | T |
| 118 | Paketat janë dëmtuar dhe nuk paraqesin një rrezik imediat. | II 2.6 | 4.1 6.1 deri në 6.6 | 22 | T |
| 119 | Transporti i paketave me ambalazh IBCs ose ambalazhet e mëdha të dëmtuara ose ambalazhet bosh të dëmtuara. | II 2.6 | 4.1 6.1 deri në 6.6 | 17 | T |
| 120 | Rezervë | | | | |
| 24. SHËNIMI I NUMRIT UN NË PAKETA/NË CISTERNA (ADR 6) | | | | | |
| 121 | Transporti i mallrave të rrezikshme në cisternat fikse, cisternat e çmontueshme, kontejnerët-cisternë, kontejnerët me gaz | I 1.15 | 6.7.2.20; 6.7.3.16; 6.7.4.15; 6.7.5.13; 6.8.2.5; 6.8.3.5; | 14 15 20 | D/T/O |



| | | | | | |
|--|--|-------------------------------------|--|---------------------|----------|
| | me elemente të shumëfishta ose kontejnerët-cisternë, etj. pa shenjat (markimin) UN, të përshkruara në pjesën 6 të ADR-së. | | 6.9.6 | | |
| 122 | Transporti i mallrave të rrezikshme pa shenjat (markën) UN në kontejnerët e mëdhenj të përshkruar në pjesën 6 të ADR-së. | I 1.15 | 6.11.3.4 | 14 15 | D/T |
| 123 | Transporti në paketa pa shenjën (markimin) UN; ambalazhet, enët e mëdha për sasi të mëdha dhe ambalazhet e mëdha, pjesa 6 e ADR-së. | I 1.14 | 6.1.3 6.2.1.7;6.2.1.8; 6.2.5.8 6.3.1 6.4.21.8 6.5.2; 6.5.4.5.3 6.6.3 | 14 15 | D/T |
| 124 | Transporti me shenjat (markimin) UN jokorrekte në cisternat, kontejnerët-cisternë, cisternat e çmontueshme, mjetet bateri dhe cisternat me gaz me elemente të shumëfishta, pjesa 6 e ADR-së. | II 2.10 | 6.7 deri në 6.10 6.12 | 14 15 20 | D/T/O |
| 125 | Transporti me shenja (markimin) UN jokorrekt në kontejnerët me përmasa të mëdha, pjesa 6 e ADR-së. | II 2.10 | 6.11 | 14 15 | D/T |
| 126 | Transporti me shenjat UN jokorrekt në paketa: ambalazhet, enët e mëdha për sasi të mëdha dhe ambalazhet e mëdha. | II 2.10 | 6.1 deri në 6.6 | 14 15 | D/T |
| 127 | Rezervë | | | | |
| 25. SHËNIMI I PAKETAVE (d.m.th. numri UN) DHE ETIKETIMI (ADR 5.2) | | | | | |
| 128 | Transporti me ambalazhe pa shenjat (markim) e kërkuara. | I 1.14 | Tabela A 5.2.1 | 7 15 17 19 | D/N/Mb/T |
| 129 | Transporti në paketa pa etiketat e kërkuara. | I 1.14 | Tabela A 5.2.2 | 7 15 17 19 | D/N/Mb/T |
| 130 | Transporti i paketave “overpack” pa shënimin (markimin) ose etiketën e kërkuar. | I 1.14 | Tabela A 5.1.2 5.2 | 7 15 17 18 | D/A/N/T |
| 131 | Transporti në paketa në sasi të kufizuara ose të përjashtuara pa shenja (markimi) e kërkuara. | I 1.14 | 3.4 3.5 | 7 15 17 18 | D/A/N/T |
| 132 | Paketimet, kontejnerët e hapur e të ndërmjetëm dhe enët e ndotura dhe bosh, pa shenja ose etiketat e kërkuara. | I 1.14 | Tabela A 5.1.3 5.2 | 7 15 17 18 | D/A/N/T |
| 133 | Paketat e përjashtuara të klasës 7 pa shenjat e detyrueshme. | I 1.1. 4 | 5.1.5.4 | 7 15 17 18 | D/A/N/T |
| 134 | Paketat përmbajnë një agjent ftohës ose kondicioner, pa etiketë ose të shprehur në pikën 5.5.3.4 të ADR-së. | I 1.14 | 5.5.3.4 | 7 15 17 18 | D/A/N/T |

| | | | | | |
|--|---|--------------------------|--|---------------------------|-----------|
| 135 | Transporti në paketa të shënuara ose etiketuara në mënyrë jokorrekte. | II 2.10 | Tabela A 3.4 dhe 3.5 5.1 dhe 5.2 | 7 15 17 19 | D/N/Mb/T |
| 136 | Madhësia e etiketave ose madhësia e shkronjave, numrave, figurave ose simboleve mbi etiketat nuk përputhet me rregulloret. | III 3.1 | Tabela A 3.4 dhe 3.5 5.1 dhe 5.2 | 7 15 17 19 | D/N/Mb/T |
| 137 | Rezervë | | | | |
| 26. ETIKETIMI I CISTERNAVE/MJETEVE (ADR 5.3.1) | | | | | |
| 138 | Transporti pa panele-etiketa në mjete, cisterna ose kontejnerët-cisternë, siç aplikohet në kapitullin 5.3 të ADR-së. | I 1.15 | Tabela A 5.3.1 | 7 15 17 19 35 | Mb/N/T/Dr |
| 139 | Transporti pa panele-etiketa në kontejnerë ose mjete, siç aplikohet në kapitullin 5.3 të ADR së. | I 1.15 | Tabela A 5.3.1 | 7 15 17 19 35 | Mb/N/T/Dr |
| 140 | Transporti pa panele-etiketa në mjete të cilat transportojnë paketa, kur është e aplikueshme në kapitullin 5.3 të ADR së. | I 1.15 | Tabela A 5.3.1 | 7 15 17 19 35 | Mb/N/T/Dr |
| 141 | Transporti në mjet, kontejnerë ose cisternë e etiketuar jokorrekt, siç parashikohet në kapitullin 5.3 të ADR së. | II 2.10 | Tabela A 5.3.1 | 7 15 17 19 35 | Mb/N/T/Dr |
| 142 | Madhësia e paneleve ose etiketave ose madhësia e shkronjave, numrave ose simboleve nuk janë në përputhje me kushtet e kapitullit 5.3 të ADR së. | III 3.1 | 5.3.1.7 | 7 15 17 19 35 | Mb/N/T/Dr |
| 143 | Rezervë | | | | |
| 27. SHËNJIMI I AUTOMJETIT/NJËSISË SË TRANSPORTIT (PANELI PORTOKALLI, TEMPERATURA E NGRITUR) | | | | | |
| 144 | Transporti pa panelet portokalli. | I 1.15 | Tabela A 5.3.2 | 15 19 | Mb/T |
| 145 | Transporti i mallrave të paketuara në sasi të kufizuar në njësitë e transportit të cilëve u mungojnë shenjat e kërkuar në kapitullin 3.4 të ADR-së. | II 2.10 | 3.4 | 15 19 | Mb/T |
| 146 | Transporti i mallrave të rrezikshme në një mjet me panele të detyrueshme portokalli, jokorrekte. | II 2.10 | Tabela A 5.3.2 | 15 19 | Mb/T |
| 147 | Transporti pa shenjat për materialet që transportohen në temperaturë të lartë. | I 1.15 | 5.3.3 | 15 19 | Mb/T |
| 148 | Transporti i substancave pa shenjen e rrezikut për mjedisit. | I 1.15 | 5.3.6 | 15 17 18 19 | A/Mb/N/T |
| 149 | Njësisë së transportit i mungon shenja paralajmëruese e bymimit. | I 1.15 | 5.5.2.3 | 15 17 18 | A/Mb/N/T |



| | | | | | |
|--|--|--------------------------|-------------------|----------------------|----------|
| | | | | 19 | |
| 150 | Mjetet ose kontejnerët që përmbajnë mallra të rrezikshme që përdoren me ftohje ose me ajër të kondicionuar i mungon shenja e detyrueshme paralajmëruese. | I 1.15 | 5.5.3.6 | 15 17 18 19 | A/Mb/N/T |
| 151 | Transporti me shenjat ose sinjalet e detyrueshme, jokorrekte. | II 2.10 | 3.4 5.3 5.5 | 15 17 18 19 | A/Mb/N/T |
| 152 | Madhësia e paneleve portokalli, markimeve ose shenjave, ose madhësia e shkronjave dhe numrave dhe figurave ose simboleve nuk janë në përputhje me rregulloret. | III 3.1 | 3.4 5.3 5.5 | 15 17 18 19 | A/Mb/N/T |
| 153 | Rezervë | | | | |
| 28. PAJISJE TË SIGURISË TË TIPIT TË PËRGGJITHSHËM TË SPECIFIKUAR NË ADR | | | | | |
| 29. PAJISJE SPECIALE NË PËRPUTHJE ME MALLRAT QË TRANSPORTOHEN | | | | | |
| 30. TIPI TJETËR I PAJISJES I SPECIFIKUAR NË INSTRUKSIONIN ME SHKRIM | | | | | |
| 154 | Mjeti nuk mban pajisjet e sigurisë të kërkuar nga ADR-ja. | II 2.4 | 5.4.3 8.1.5 | 35 | T |
| 155 | Njësia e transportit nuk mban në bord bllokuesit e rrotave. | II 2.4 | 8.1.5.2 | 35 | T |
| 156 | Njësia e transportit nuk mban në bord dy sinjale paralajmëruese. | II 2.4 | 8.1.5.2 | 35 | T |
| 157 | Njësia e transportit nuk mban në bord lëng për larjen e syve, kur është e zbatueshme. | II 2.4 | 8.1.5.2 | 35 | T |
| 158 | Njësia e transportit nuk mban në bord veshjen paralajmëruese për secilin anëtar të ekuipazhit. | II 2.4 | 8.1.5.2 | 35 | T |
| 160 | Njësia e transportit nuk mban në bord pajisje portative ndriçimi të ftohtë për secilin anëtar të ekuipazhit. | II 2.4 | 8.1.5.2 | 35 | T |
| 161 | Njësia e transportit nuk mban në bord nga një palë doreza për secilin anëtar të ekuipazhit. | II 2.4 | 8.1.5.2 | 35 | T |
| 162 | Njësia e transportit nuk mban në bord nga një palë syze për secilin anëtar të ekuipazhit. | II 2.4 | 8.1.5.2 | 35 | T |
| 164 | Mjeti nuk mban pajisjen respiratore (kundërgazin) të duhur. | II 2.4 | 8.1.5.3 | 35 | T |
| 165 | Njësia e transportit nuk është e pajisur me lopatë, kur është e aplikueshme. | II 2.4 | 8.1.5.3 | 35 | T |
| 166 | Njësia e transportit nuk është e pajisur me një mbulesë për largimin e lagështirës apo bllokimin e rrjedhjes. | II 2.4 | 8.1.5.3 | 35 | T |
| 167 | Njësia e transportit nuk është e pajisur me një kolektor mbledhës, nëse është e aplikueshme. | II 2.4 | 8.1.5.3 | 35 | T |
| 168 | Në mjet nuk ndodhen pajisjet e duhura personale mbrojtëse dhe pajisje shtesë ose të veçanta, të cilat mund të jenë parashikuar nga instruksionet me shkrim. | II 2.4 | 5.4.3 8.1.5.3 | 35 | T |
| | Rezervë | | | | |
| | Rezervë | | | | |

| 31. PAJISJET PËR FIKJEN E ZJARRIT | | | | | |
|--|--|-------------------|----------------|----------------------|------------------|
| 169 | Njësia e transportit në përputhje me 1.1.3.6 nuk ka pajisjen portative të detyrueshme për fikjen e zjarrit. | II 2.3 | 8.1.4.2 | 35 | T |
| 170 | Njësia e transportit nuk ka pajisjen portative, të detyrueshme për fikjen e zjarrit, për motorin ose kabinën. | II 2.3 | 8.1.4.1 | 35 | T |
| 171 | Njësia e transportit nuk ka pajisje shtesë për fikjen e zjarrit. | II 2.3 | 8.1.4.1 | 35 | T |
| 172 | Pajisjet për fikjen e zjarrit nuk janë të vulosura që dëshmon që ato janë të papërdorura. | II 2.3 | 8.1.4.4 | 35 | T |
| 173 | Pajisjet për fikjen e zjarrit nuk janë të shënuara (markuara) në përputhje me një standard të njohur nga autoriteti përgjegjës dhe të jenë pajisur me një targetë ku të përmbahen të paktën, data (muaji dhe viti) i inspektimit periodik të ardhshëm ose data e skadimit. | II 2.3 | 8.1.4.4 | 35 | T |
| 174 | Pajisjet për fikjen e zjarrit nuk kanë qenë subjekt i një inspektimi të rregullt, në mënyrë që të sigurohet sigurohemi që ato funksionojnë në rregull. | II 2.3 | 8.1.4.4 | 35 | T |
| 175 | Pajisjet për fikjen e zjarrit nuk instalohen në njësitë e transportit në mënyrë të tillë që ato të jenë lehtësisht të manipulueshme nga ekuipazhi i mjetit. | II 2.3 | 8.1.4.5 | 35 | T |
| 176 | Instalimi i pajisjeve të fikjes së zjarrit nuk kryhet në mënyrë të tillë që të jenë të mbrojtura nga efektet e motit dhe që të mos preket efektshmëria e sigurisë operacionale të tyre. | II 2.3 | 8.1.4.5 | 35 | T |
| 177 | Rezervë | | | | |
| 178 | Rezervë | | | | |
| TË NDRYSHME (NUK NDODHEN NË ANEKSIN II) | | | | | |
| 179 | Përdorimi i zjarrit ose flakës së pambrojtur në mjete ose në kontejnerë që përmbajnë mallra të rrezikshme, në afërsi të tyre dhe gjatë ngarkimit ose shkarkimit të këtyre mallrave. | I 1.18 | 7.5.11 CV2 (2) | 17 19 35 36 | Dr/E/N/Mb/ Sh |
| 180 | Pirja e duhanit dhe përdorimi i zjarrit ose flakës së pambrojtur në mjete ose në kontejnerë që përmbajnë substanca të klasës 1, në afërsi të tyre dhe gjatë ngarkimit ose shkarkimit të këtyre mallrave. | I 1.18 | 8.5 S1 (3) | 17 19 35 36 | Dr/E/N/Mb/ Sh |
| 181 | Pajisjet e ndriçimit që përdoren kanë sipërfaqe metalike dhe mund të prodhojnë shkëndija. | I 1.18 | 8.3.4 | 35 | Dr/E |
| 182 | Përdorimi i ndriçimit të pambrojtur | I 1.18 | 8.3.4 | 35 | Dr/E |
| 183 | Njësia e transportit përmban më shumë se një rimorkio ose gjysmërimorkio | II 2.1 | 8.1.1 | 35 15 35 | D/T/Dr |



| | | | | | |
|-----|--|--------------------------|----------------|----------------------|------------------|
| 184 | Pihet duhan kur ka ndodhur një aksident ose emergjencë. | I 1.19 | 5.4.3 | 17 19 35 36 | Dr/E/N/Mb/ Sh |
| 185 | Pirja e duhanit në afërsi të mjetit ose kontejnerit, ose brenda mjetit ose kontejnerit, gjatë trajtimit. | I 1.19 | 7.5.9 8.3.5 | 17 19 35 36 | Dr/E/N/Mb/ Sh |
| 186 | Mos ndalimi i pirjes së duhanit. | I 1.19 | 7.5.9 8.3.5 | 17 19 35 36 | Dr/E/N/Mb/ Sh |
| 187 | Në bordin e mjetit ndodhen udhëtarë. | | 8.3.1 | 14 35 | T/Dr/E |
| 188 | Mjeti nuk është parkuar ose mbikëqyr siç duhet. | II 2.12 | 8.4 | 35 36 | Dr/E |
| 189 | Mjeti cisternë nuk është i tokëzuar mirë me një lidhje elektrike para mbushjes ose zbrazjes. | II 2.4 | 8.5 S2 (3) | 35 17 | Dr/N/Sh |

ANEKSI VI

KONTROLLI PËR SHKELJET QË MUND TË NDODHIN NË MJEDISËT E SUBJEKTIT

Ne duhet të kemi parasysh detyrimin e subjekteve për të mbajtur 5 vjet dokumentet e transportit dhe dokumentacionin në lidhje me funksionimin e shërbimit të transportit për 5 vjet. Kontrollat në mjediset e ndërmarrjes mund të bëhen në subjektet e dërguesit, ngarkuesit, transportuesit, marrësit, shkarkuesit, pra të gjithë pjesëmarrësit në transportin e mallrave të rrezikshme.

Procesi i kontrollit kryhet duke ndjekur zërat në tabelat e mëposhtme A dhe B. Në këto tabela do të shihet se çfarë mund të kontrollohet në njërin prej posteve të subjektit.

Në tabelën B të këtij aneksi, jepen shkeljet e konstatuara për këshilltarin e sigurisë dhe të subjektit pjesëmarrës në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme. Në kolonën e tretë jepet kategoria e rrezikut, por në ndryshim nga tabelat e tjera ku jepet edhe pozicioni i kategorisë së rrezikut sipas aneksit II të direktivës 95/50/EC ose aneksit III të këtij udhëzimi, këto anekse nuk parashikojnë shkeljet e paraqitura në këtë aneks.

**A. SHKELJET SIPAS DIREKTIVËS SË KONTROLLIT 95/50/EC DHE LIGJIT
NR.18/2012, DATË 13.12.2012**

| Nr. | Përshkrimi i shkeljes sipas ADR | Kategoria e rrezikut sipas aneksit II të D.95/50/EC | Shkeljet e dispozitave të ADR së 2013 | Shkeljet e dispozitave të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012 Neni/nenet |
|--|--|---|--|---|
| PËRDORIMI I LISTËS SË KONTROLLIT SIPAS DIREKTIVËS 95/50/EC E NDRYSHUAR ME DIREKTIVËN 2004/12/EC DHE PËRPUTHJA E SHKELJEVE ME ADR DHE LIGJIN NR. 118/2012, DATË 13.12.2012 | | | | |
| 13. DOKUMENTET E TRANSPORTIT | | | | |
| 1 | Dokumentet e transportit të mallrave të rrezikshme nuk janë dhënë ose nuk janë në përputhje me ADR-në. | I 1.14 | 8.1.2.1 (a) dhe 5.4.1 | 14 |
| 2 | Transporti i mallrave të rrezikshme pa identifikuar mallrat e rrezikshme të transportuar në fletëngarkesën e shoqërimit të mallit. | I 1.14 | 8.1.2.1 (a) dhe 5.4.1 | 14 |
| 3 | Dokumenti i transportit pa numrin e duhur të UN, emërtimin e përshtatshëm, grupin e transportit dhe disa informacione të tjera përkatëse. | I 1.16 | 5.4.1.1.1 | 14 |
| 4 | Transporti i mallrave me mjet, kontejner dhe/ose cisternë (Nr.UN 3359) me trajtim tymosjeje pa fletëngarkesën e shoqërimit të mallit sipas nënseksionit të përmendur në 5.5.2.1 të ADR-së. | I 1.16 | 5.5.2.1 | 14 |
| 5 | Informacioni i kërkuar në dokumentin e transportit është i palexueshëm. | I 1.16 | 5.4.1.1.2 | 14 |
| 6 | Mungesa ose keqpërdorimi i numrit dhe përshkrimit të paketave ose të IBCs, peshës bruto apo neto për materialet dhe objektet e LP. | I 1.16 | 5.4.1.1.1 (e), (f) dhe 5.4.1.2.1 (a) | 14 |
| 7 | Nuk tregojnë ose nuk përshkruajnë mjetet mbajtëse bosh e të papastra. | III 3.2 | 5.4.1.1.6 | 14 |
| 8 | Nuk tregon emrin dhe adresën e dërguesit. | III 3.2 | 5.4.1.1.1 (g) | 14 |
| 9 | Nuk tregohet emri dhe adresa e marrësit (destinacionit) | III 3.2 | 5.4.1.1.1 (h) | 14 |
| 10 | Dokumenti nuk është shkruar me gjuhë korrekte. | III 3.2 | 5.4.1.4 | 14 |
| 11 | Mungesa e dokumenteve në lidhje me përjashtimet e ADR | I 1.16 | 4.3 dhe 1.5.1 | 14 |
| 12 | Mungesa e përmendjes, së të qenit pjesë e një zinxhiri të transportit ajror ose detar, në dokumentin e transportit | III 3.2 | 5.4.1.1.7 | 14 |
| 13 | Mungesa e një informacioni shtesë në lidhje me kërkesat e veçanta ose speciale (p.sh. rikuperimi ose mbetjet). | I 1.16 | 5.4.1 | 14 |
| 14 | Transporti i mallrave të rrezikshme të klasës 7 pa bashkëlidhur deklaratën e dërguesit në faturën e shoqërimit të mallit në lidhje me masat që transportuesi merr, nëse ka. | I 1.16 | 5.4.1.2.5.2 | 14 |
| 15 | Dokumentet e transportit nuk përmbajnë informacion korrekt (e ndryshme nga të mëparshme) | III 3.2 | 5.4.1 | 14 |
| 16 | Transporti i mallrave të rrezikshme pa një certifikatë koresponduese të paketimit të kontejnerit kur transporti i paraprur një udhëtimi në det. | III 3.2 | 5.4.2 | 14 |



| | | | | |
|---|---|--------------------------|----------------------------------|-----------------|
| 17 | Certifikata e mjetit/kontejnerit nuk është përgatitur në përputhje me seksionin 5.4.2 të kodit IMDG. | III 3.2 | 5.4.2 | |
| 18 | Rezervë | | | |
| 18. MALLRAT E AUTORIZUARA PËR TRANSPORT | | | | |
| 19 | Mallrat e rrezikshme janë të ndaluar për transport. | I 1.1 | Tabela A dhe B dhe Pjesa 2 | 14 15 |
| 20 | Transporti i mallrave të rrezikshme pa praninë, d.m.th. e dokumenteve, shenjave dhe etiketave në paketa, etiketave dhe shenjave në mjet. | I 1.14 | Pjesa 5 dhe Kapitulli 8.1 | 7 |
| 21 | Transporti i mallrave të rrezikshme në paketa që nuk lejohen nga ADR-ja. | I 1.3 | Tabela A Kolona (8) | 7 |
| 22 | Transporti i mallrave të rrezikshme në cisterna që nuk lejohen nga ADR-ja. | I 1.3 | Tabela A Kolonat (10) dhe (12) | 7 9 |
| 23 | Transporti i mallrave të rrezikshme në sasi të madhe (bulk) që nuk lejohen nga ADR-ja. | I 1.3 | Tabela A Kolona (10) | 7 |
| 24 | Shkelja e dispozitave që kufizojnë sasinë që transporton një njësi e transportit. | I 1.3 | 7.5.5 | 14 15 |
| 19. MJETI I AUTORIZUAR PËR TRANSPORT | | | | |
| 25 | Transporti i mallrave të rrezikshme në paketa (klasa 1) ose në mjete-cisternë që nuk janë autorizuar në transportin e mallrave të rrezikshme. | I 1.3 | Tabela A Kolona (14) dhe 9.1.1.2 | Nenet 7 9 |
| 20. DISPOZITAT NË LIDHJE ME MËNYRËN E TRANSPORTIT (NË SASI TË MËDHA, PAKO, CISTERNA) | | | | |
| 26 | Transporti i mallrave të rrezikshme i kryer në një cisternë të paautorizuar për të njëjtin artikull. | I 1.3 | Tabela A Kolonat (10) dhe (12) | 14 15 |
| 27 | Transporti i mallrave të rrezikshme të hapur në sasi të madhe në një kontejner të paautorizuar për të njëjtin artikull. | I 1.3 | Tabela A Kolonat (10) dhe (12) | 14 15 |
| 28 | Përdorimi i paautorizuar i ambalazhit | I 1.7 | Tabela A dhe 6.1 dhe 6.2 | 7 |
| 21. NDALIMI I NGARKESAVE TË PËRZIERA | | | | |
| 29 | Mospërmbushja e dispozitave të veçanta në ambalazhimin (paketimin) e përbashkët. | I 1.9 | Tabela A dhe 4.1.10 | 14 |
| 30 | Mospërmbushja e dispozitave mbi ngarkesat e përbashkëta të paketave. | I 1.11 | Kapitulli 7.5 | 15 |
| 22. NGARKESA, FIKSIMI I NGARKESËS DHE TRAJTIMI (MANIPULIMI) | | | | |
| 31 | Mospërmbushja e dispozitave mbi mbushjen e lejuar të cisternave dhe ambalazheve | I 1.12 | Pjesët 4 dhe 6 | 19 15 |

B. SHKELJET MBI DETYRIMET E KËSHILLTARIT TË SIGURISË

| | | | | | |
|---|---|-----------|---------|----|----|
| SHKELJET SIPAS ADR 2013 DHE LIGJIT NR. 118/2012, DATË 13.12.2012 | | | | | |
| A. KËSHILLTARI I SIGURISË | | | | | |
| 1 | Këshilltari i sigurisë nuk ka kryer funksionet që i janë caktuar për dërgimin, transportin, marrësin, ngarkimin, mbushjen shkarkimin, e mallrave të rrezikshme. | II | 1.8.3.3 | 30 | KS |
| B. INFORMACIONI VJETOR | | | | | |
| 2 | Këshilltari i sigurisë nuk përgatit raportin vjetor. | II | 1.8.3.3 | 30 | KS |

| | | | | | |
|---|--|-----------|------------------------------------|----------|--------|
| 3 | Nuk ruan në mjediset e ndërmarrjes raportet vjetore gjatë periudhës që parashikon ligji, duke mos e dorëzuar në organet përgjegjëse. | II | 1.8.3.3 | 30 | KS |
| 4 | Këshilltari i sigurisë nuk përgatit raportin për aksidentin. | II | 1.8.3.6 | 30 | KS |
| 5 | Nuk dërgon në kohën e caktuar raportin vjetor tek autoritet përgjegjëse. | II | | 29 | KS |
| 6 | Në raportet vjetore nuk përfshihen të dhënat e kërkuara në ADR. | II | 1.8.5.4 | 29 | KS |
| C. DETYRIMET E SUBJEKTIT PËR KËSHILLTARIN E SIGURISË | | | | | |
| 1 | Nuk ka emëruar (caktuar) këshilltar të sigurisë. | I | 1.8.3.1 | 29 | D/T |
| 2 | Këshilltari i sigurisë i caktuar nuk zotëron një certifikatë të vlefshme trajnimi. | I | 1.8.3.7 | 29 | D/T/KS |
| 3 | Autoriteti përgjegjës nuk është informuar për identitetin e këshilltarit të sigurisë. | II | 1.8.3.5 | 29 | D/T/KS |
| 4 | Raporti vjetor ose raporti i aksidentit nuk janë të disponueshëm. | II | 1.8.3.3, 1.8.3.1 dhe 1.8.3.6 | 30 | D/T/KS |
| 5 | Rezervë | | | | |
| D. TRAJNIMI I PERSONAVE PJESEMARRËS NË TRANSPORT | | | | | |
| 1 | Nuk u jepet punonjësve trajnimi i duhur për sigurinë, në përputhje me ADR-në, punonjësve. | II | 1.3 dhe 1.10.2 | 32 | D/T |
| 2 | Rezervë | | | | |
| E. PLANI I SIGURISË | | | | | |
| 1 | Plani i sigurisë nuk është i disponueshëm ose nuk është i përshtatshëm. | I | 1.10.3.2 dhe 1.10.3.3 | 14 15 | D/T |
| 2 | Rezervë | | | | |



**ANEKSI VII
PROCESVERBAL
PËR MARRJEN E MOSTRAVE/KAMPIONE TË MALLRAVE TË RREZIKSHME PËR
PROVA LABORATORIKE**

Në zbatim të neneve 39 dhe 40 të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme” tërhoqa mostrën/kampionin për prova laboratorike të artikullit/substancës së rrezikshme në sasinë e poshtëshënuar.

Nr. serisë:

1. Subjekti

Emri tregtar i subjektit pjesëmarrës:.....

Emri i drejtuesit të mjetit:.....

Adresa tregtare e ndërmarrjes....., Kodi postar.....

2. Emri i organit/organeve të kontrollit:.....

3. Artikulli/substanca e rrezikshme

Emërtimi i artikullit/substancës së rrezikshme sipas dokumenteve të shoqërimit¹

Numri UN i artikullit/substancës së rrezikshme sipas dokumenteve të shoqërimit²:.....

Gjendja e artikullit/substancës së rrezikshme:

E ngurtë

E gaztë

E lëngët

Përbën rrezik për sigurinë tërheqja e artikullit/substancës së rrezikshme: Po Jo

Jeni instruktuar ose njohur mbi pasojat e rrezikut që paraqet tërheqja e artikullit/substancës së rrezikshme: Po Jo

Keni marrë masat e duhura për shmangien e rrezikut gjatë procesit të tërheqjes së artikullit/substancës së rrezikshme: Po Jo

Jeni pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e procesit të tërheqjes së artikullit/substancës së rrezikshme: Po Jo

Sasia e artikullit/substancës së rrezikshme që merret për mostër/kampion.....

¹Nëse artikulli ose substanca e rrezikshme nuk ka emërtim, të shkruhen fjalët “Nuk ka emërtim”

² Nëse artikulli ose substanca e rrezikshme nuk ka numrin e UN, të shkruhet fjalët “Nuk ka numrin e UN”

4. Mjeti (kur tërheqja e mostrës/kampionit ndodh në rrugë)

Numri i regjistrimit të mjetit.....

Lloji i mjetit Traktor i artikuluar I ngurtë

Rimorkio me aks në qendër Rimorkio e plotë me krah lidhës Gjysmërimork.

A është një mjet i lehtë mallrash d.m.th. TPL 3001 kg deri 3500 kg? Po Jo

Vendndodhja e tërheqjes së mostrës: në rrugë: në ndërmarrje:

5. Të dhënat e mjetit që kryen transportin e mostrës/kampionit të artikullit/substancës së rrezikshme dhe drejtuesit të mjetit

Numri i regjistrimit të mjetit:.....

Emri dhe mbiemri i drejtuesit të mjetit:.....

Lloji i mjetit: Traktor i artikuluar I ngurtë

Rimorkio me aks në qendër Rimorkio e plotë me krah lidhës Gjysmërimork.

A është një mjet i lehtë mallrash d.m.th. TPL 3001 kg deri 3500 kg? Po Jo

mjeti është pronë: private publike

6. Laboratori

Emri tregtar i laboratorit të akredituar dhe/ose notifikuar

Adresa tregtare e laboratorit....., kodi postar.....
.....

(Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për kontroll)
Shoqëruar me nënshkrimin.

(Emri dhe mbiemri i pronarit³ të artikullit/subst.)
Shoqëruar me nënshkrimin.

Data:

³ Kur kontrolli kryhet në rrugë, vendoset emri i drejtuesit të mjetit.



ANEKSI VIII INFORMACION I PËRGJITHSHËM I KËRKUAR NË DOKUMENTIN E TRANSPORTIT SIPAS PIKËS 5.4.1 TË ADR-së

Dokumenti i transportit duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme për çdo lëndë, material ose artikull të rrezikshëm, të ofruar për transport:

- a) numri i UN të paraprirë nga shkronjat “UN”;
- b) emri përkatës i transportit i shoqëruar sipas rastit (shih 3.1.2.8.1) me emrin teknik në kllapa (shih 3.1.2.8.1.1), përcaktuar në përputhje me 3.1.2;
- c) - për lëndët dhe artikujt e klasës 1: kodi i klasifikimit dhënë në kolonën (3b) të tabelës A të kapitullit 3.2.

Në rastin kur jepen në kolonën (5) të tabelës A të kapitullit 3.2, numrat e modelit të etiketës të ndryshëm nga 1, 1.4, 1.5 dhe 1.6, këto numra të modelit të etiketës, në kllapa, duhet të ndjekin kodin e klasifikimit;

- për materialet radioaktiv të klasës 7: numrin e klasës: “7”;

Shënim. Për materialin radioaktiv me rrezik dytësor, shih gjithashtu dispozitën e veçantë 172 në kapitullin 3.3.

- për lëndët dhe artikujt e klasave të tjera: numrat e modelit të etiketës dhënë në kolonën (5) të tabelës A të kapitullit 3.2 ose të zbatueshëm sipas dispozitës së veçantë referuar në kolonën 6. Në rastin kur jepen numra për më shumë se një model etikete, numrat që ndjekin modelin e parë duhet të jepen në kllapa. Për lëndët dhe artikujt për të cilët nuk jepet asnjë model etikete në kolonën (5) të tabelës A të kapitullit 3.2, në vend të saj jepet klasa sipas kolonës (3a);

- d) kur caktohet, numri i ambalazhimit për lëndë që mund të paraprihet nga shkronjat “PG” (p.sh. “PGII”), ose inicialet që korrespondojnë me fjalët “Grupi i ambalazhimit” në gjuhën e përdorur sipas 5.4.1.4.1;

Shënim. Për materialet radioaktive të klasës 7 me rrezik dytësor, shih dispozitën e veçantë 172 (b) në kapitullin 3.3.

- e) numri dhe përshkrimi i ambalazhimit sipas rastit. Kodet e ambalazhimit të UN mund të përdoren vetëm për të plotësuar përshkrimin e llojit të ambalazhimit (p.sh. një kuti (4G));

Shënim. Numri, tipi dhe kapaciteti i çdo ambalazhimi të brendshëm brenda ambalazhimit të jashtëm të një ambalazhimi të kombinuar nuk është i nevojshëm të tregohet.

- f) sasia e përgjithshme e çdo artikulli të mallrave të rrezikshme që mbajnë numër të ndryshëm të UN, emrin përkatës të transportit ose, sipas rastit, grupin e ambalazhimit (si vëllimi ose si pesha e përgjithshme, apo si pesha neto sipas rastit);

Shënim 1. Në rastin e zbatimit të planifikuar të 1.1.3.6, sasia e përgjithshme e mallrave të rrezikshme për çdo kategori transporti duhet të tregohet në dokumentin e transportit në përputhje me 1.1.3.6.3.

Shënim 2. Për mallrat e rrezikshme në makineri ose pajisjet e specifikuara në këtë shtojcë, sasia e treguar duhet të jetë sasia e përgjithshme e mallrave të rrezikshme që ndodhen në to në kilogram ose litra sipas rastit.

- g) emri dhe adresa e dërguesit të mallit;

h) emri dhe adresa e pritësit (pritësve) të mallit. Me marrëveshjen e autoriteteve përgjegjëse të vendeve të përfshira në transport, në rastin kur mallrat e rrezikshme transportohen për t’ia dorëzuar disa pritësve të mallit, të cilët nuk mund të identifikohen në fillimin e transportit, mund të vendosen në vend të emrit të tyre fjalët “Shitje me transferim”;

- i) deklarata e kërkuar sipas kushteve të çdo marrëveshjeje të veçantë;

j) *(e rezervuar)*

- k) Kur caktohet, kodi i kufizimit të tunelit dhënë në kolonën (15) të tabelës A të kapitullit 3.2, me shkronja kapitale në thonjëza. Kodi i kufizimit të tunelit nuk është e nevojshme të shtohet në

dokumentin e transportit në rastin kur dihet paraprakisht se transporti nuk do të kalojë në një tunel me kufizime për transportin e mallrave të rrezikshme.

Vendi dhe renditja në të cilin duhet të paraqiten elementet e të dhënave në dokumentin e transportit, është sipas dëshirës, përveç faktit që: (a), (b), (c), (d) dhe (k) duhet të paraqiten në renditjen e dhënë më lart (p.sh. (a), (b), (c), (d), (k)) pa i shpërndarë të dhënat, me përjashtim të parashikimit në ADR.

Shembuj të përshkrimeve të tilla të lejuara të mallrave të rrezikshme janë:

**“ALKOOL ALILI I UN 1098, 6.1(3), I (C/D)” ose
“ALKOOL ALILI I UN 1098, 6.1(3), PG I (C/D)”**

Të dhënat e kërkuara në dokumentin e transportit duhet të jenë të lexueshme.

Megjithëse përshkrimi i parë përdoret në kapitullin 3.1 dhe në tabelën A të kapitullit 3.2 për të treguar elementet që duhet të jenë pjesë e emrit përkatës të transportit dhe, megjithëse, përshkrimi i parë dhe i dytë përdoren në këtë kapitull për të treguar të dhënat e kërkuara në dokumentin e transportit, me përjashtim të parashikimit në 5.4.1.1.1 (k), përdorimi i përshkrimit të parë dhe të dytë për përfshirjen e të dhënave në dokumentin e transportit, lihet sipas dëshirës.

Dispozita të veçanta për mbeturinat

Nëse transportohen mbeturina që përmbajnë mallra të rrezikshme (përveç mbeturinave radioaktive), emri përkatës i transportit duhet të paraprihet nga fjala **“MBETURINA”**, në qoftë se ky term nuk është pjesë e emrit përkatës të transportit, p.sh.:

“MBETURINA METANOLI të UN 1230, 3(6.1), II, (D/E)”,

Nëse mallrat e rrezikshme mbarten në ambalazhe ose në enë nën presion shpëtimi, fjalët **“AMBALAZHIM PAKETIMI”** ose **“ENË NËN PRESION SHPËTIMI”** do të shtohen pas përshkrimit të mallrave të rrezikshme.

Dispozita speciale për mjetet bosh të kontaminuara, të papastra.

Për mjetet e boshatisura të bartura, të papastra, të cilat përmbajnë mbeturinat e mallrave të rrezikshme të klasave të ndryshme nga klasa 7, duhet të vendosen para ose pas përshkrimit të mallrave të rrezikshme specifikuar në 5.4.1.1.1 (a) deri në (d) dhe (k) fjalët **“I BOSHATISUR, I PAPASTRUAR”** ose **“MBETURINË, BARTUR SË FUNDMI”**. Për më tepër, 5.4.1.1.1 (f) nuk zbatohet.

Dispozitat e veçanta për transportin në transportin zinxhir përfshirë transportin detar ose ajror

Për transportin në përputhje me 1.1.4.2.1, duhet të përfshihet në dokumentin e transportit emërtimi: **“Transport në përputhje me 1.1.4.2.1”**.

Dispozitat e veçanta për transportin në mjetet cisternë me shumë kompartimente ose njësitë transportuese me më shumë se një cisternë

Kur nga devijimi 5.3.2.1.2, mjeti-cisternë me shumë kompartimente ose njësia transportuese me më shumë se një cisternë pajiset me shenja në përputhje me 5.3.2.1.3, lëndët që gjenden në çdo cisternë apo në çdo kompartiment të cisternës, duhet të specifikohen në dokumentin e transportit.

Dispozitat e veçanta për transportin e lëndëve të bartura në temperaturë të ngritur

Nëse emri përkatës i transportit të lëndës që transportohet ose ofrohet për transportim në gjendje të lëngshme në temperaturë të barabartë ose më të lartë se 100°C, ose në gjendje të ngurtë në temperaturë të barabartë ose më të lartë se 240°C, nuk mbart gjendjen e temperaturës së ngritur (për shembull, duke përdorur termin **“E SHKRIRË”** ose **“TEMPERATURË E NGRITUR”** si pjesë e emrit përkatës të transportit), duhet të vendoset menjëherë para emrit përkatës të transportit fjala **“E NXEHTË”**.



Në rastin kur kërkohet sipas dispozitës së veçantë 640 të kapitullit 3.3, dokumenti i transportit duhet të mbajë shkrimin “Dispozita e veçantë 640X” ku “X” është shkronja kapitale që vendoset pas referencës shtesë të dispozitës së veçantë 640 në kolonën (6) të tabelës A të kapitullit 3.2.

Dispozitat e veçanta për transportin e lëndëve të stabilizuara nëpërmjet kontrollit të temperaturës

Nëse fjala “**E STABILIZUAR**” përfshihet në emrin përkatës të transportit (shih gjithashtu 3.1.2.6), kur stabilizimi arrihet nëpërmjet kontrollit të temperaturës, në dokumentin e transportit duhet të paraqiten temperaturat e kontrollit dhe rasteve emergjente (shih 2.2.41.1.17), në vijim: “**Temperatura e kontrollit:...°C Temperatura në rast emergjence:...°C**”




Dispozitat e veçanta për transportin e lëndëve të rrezikshme për mjedisin (mjedisin ujor)







Kur lënda që i përket një prej klasave 1 deri në 9 plotëson kriteret e klasifikimit të 2.2.9.1.10, në dokumentin e transportit shtohet shkrimi “**E RREZIKSHME PËR MJEDISIN**”.

Shkrimi “NDOTËS DETAR/ E RREZIKSHME PËR MJEDISIN”. Kjo kërkesë shtesë nuk zbatohet për Nr. 3077 dhe 3082 të UN ose për rastet shumë të vogla e renditura në 5.2.1.8.1. Shkrimi “**NDOTËS DETAR**” (sipas 5.4.1.4.3 të kodit të IMDG) pranohet për transportin në një zinxhir transportin që përfshin transportin detar.








Informacion shtesë ose të veçantë të nevojshme për klasa të caktuara janë dhënë në pikën 5.4.1.2.


ANEKSI IX

| Udhëzuesi shtesë për anëtarët e ekuipazhit të mjetit në lidhje me karakteristikat e rrezikut të mallrave të rrezikshme sipas klasës dhe masat që duhen marrë sipas rrethanave mbizotëruese | | |
|--|--|--|
| Etiketat dhe tabelat e rrezikut | Karakteristikat e rrezikut | Udhëzues shtesë |
| (1) | (2) | (3) |
| Artikuj dhe lëndë eksplozive  | Mund të kenë një sërë veçorish dhe efektesh të tilla si shpërthimi i masës, hedhja e copëzave, fluks i madh zjarri/nxehtësie; krijimi i dritës së fortë, zhurma e fortë apo tymi. Të ndjeshme ndaj përplasjeve dhe/ose goditjeve dhe/ose nxehtësisë | Të mbahet maskë, por të qëndrohet larg dritareve. |
| Artikuj dhe lëndë eksplozive  | Rrezik i vogël shpërthimi dhe zjarri | Të mbahet masë. |
| Gaze të djegshme  | Rrezik zjarri. Rrezik shpërthimi. Mund të jenë nën presion. Rrezik asfiksioni. Mund të shkaktojnë djegie dhe/ose ngrirje. Përmbajtja mund të shpërthejë kur ngrohet | Të mbahet maskë. Të qëndrohet larg zonave të ulëta. |

| | | |
|--|---|--|
| <p>Gaze jotoksike, të padjeshme</p>  <p>2.2</p> | <p>Rrezik asfiksimi. Mund të jenë nën presion. Mund të shkaktojnë ngrirje. Përmbajtja mund të shpërthejë kur ngrohet.</p> | <p>Të mbahet maskë. Të qëndrohet larg zonave të ulëta.</p> |
| <p>Gaze toksike</p>  <p>2.3</p> | <p>Rrezik helmimi. Mund të jenë nën presion. Mund të shkaktojnë djegie dhe/ose ngrirje. Përmbajtja mund të shpërthejë kur ngrohet.</p> | <p>Të përdoret maska e shpëtimit për raste emergjente. Të mbahet maskë. Të qëndrohet larg zonave të ulëta.</p> |
| <p>Lëndë të lëngshme të djegshme</p>  <p>3</p> | <p>Rrezik zjarri. Rrezik shpërthimi. Përmbajtja mund të shpërthejë kur ngrohet.</p> | <p>Të mbahet maskë. Të qëndrohet larg zonave të ulëta.</p> |
| <p>Lëndë të ngurta të djegshme, lëndë vetëreaktive dhe lëndë eksplozive të ngurta të pandjeshme</p>  <p>4.1</p> | <p>Rrezik zjarri. Të djegshme, mund të ndizen nga ngrohja, shkëndijat ose flakët. Mund të përmbajnë lëndë vetëreaktive që mund të pësojnë shpërbërje ekzotermike në rastin e shtimit të nxehtësisë, kontaktit me lëndë të tjera (të tilla, si: acidet, përbërjet prej metali të rëndë ose aminet), fërkimit ose goditjes. Një gjë e tillë mund të rezultojë në zhvillimin e gazeve apo avujve të lëngshëm dhe të djegshëm ose mund të rezultojë në vetëndezeje. Përmbajtja mund të shpërthejë kur ngrohet. Rrezik shpërthimi i lëndëve eksplozive të pandjeshme pas humbjes së agjentit flegmatizues.</p> | |
| <p>Lëndë që mund të digjen vetvetiu</p>  <p>4.2</p> | <p>Rrezik zjarri nga djegia spontane nëse ambalazhimet dëmtohen ose përmbajtja derdhet. Mund të kundërveprojnë në mënyrë të fuqishme me ujën.</p> | |
| <p>Lëndë që, në kontakt me ujën, çlirojnë gaze të djegshme</p>  <p>4.3</p> | <p>Rrezik zjarri dhe shpërthimi në kontakt me ujën.</p> | <p>Lëndët e rrjedhura duhet të ruhen të thata duke mbuluar rrjedhjet e krijuara.</p> |





| | | |
|--|---|---|
| Lëndë oksiduese  5.1 | Rrezik reaksioni të fortë, ndezjeje dhe shpërthimi në kontakt me lëndë të djegshme. | Të shmanget përzierja me lëndë të djegshme (p.sh. tallash). |
| Perokside organike  5.2 | Rrezik shpërbërjeje ekzotermike në temperatura të ngritura, në kontakt me lëndë të tjera (të tilla, si: acidet, përbërjet prej metali të rëndë ose aminet), fërkimit ose goditjes. Një gjë e tillë mund të rezultojë në zhvillimin e gazeve apo avujve të lëngshëm dhe të djegshëm ose mund të rezultojë në vetëndezje. | Të shmanget përzierja me lëndë të djegshme (p.sh. tallash). |
| Lëndë toksike  6.1 | Rrezik helmimi nga thithja, kontakti me lëkurën ose gëlltitja. Rrezik për mjedisin ujor ose sistemin e ujërave të zeza. | Të përdoret maska e shpëtimit për raste emergjente. |
| Lëndë infektive  6.2 | Rrezik infektimi. Mund të shkaktojnë sëmundje të rënda në njerëz ose kafshë. Rrezik për mjedisin ujor ose sistemin e ujërave të zeza. | |
| Material radioaktiv  7A 7B 7C 7D | Rrezik i thithjes dhe rrezatimit të jashtëm. | Kohë e limituar ekspozimi. |
| Material që shpërbëhet  7E | Rrezik i reaksionit zinxhir bërthamor. | |
| Lëndë gërryese  8 | Rrezik djegieje nga gërryerja. Mund të kundërveprojnë në mënyrë të fuqishme me njëra-tjetrën, me ujin dhe me lëndë të tjera. Lënda e rrjedhur mund të krijojë avuj gërryes. Rrezik për mjedisin ujor ose sistemin e ujërave të zeza. | |

| | | |
|--|---|--|
| Artikuj dhe lëndë të rrezikshme të përziera  | Rrezik djegieje. Rrezik zjarri. Rrezik shpërthimi. Rrezik për mjedisi uJOR ose sistemin e ujërave të zeza. | |
|--|---|--|

Shënim 1. Për mallrat e rrezikshme me shumë rreziqe dhe për ngarkesat e përziera, duhet të respektohet çdo emërtim i zbatueshëm.

Shënim 2. Udhëzuesi shtesë paraqitur më lart mund të përshtatet për të pasqyruar klasat e mallrave të rrezikshme që do të transportohen dhe mjetet e tyre të transportit.

| Udhëzuesit shtesë për anëtarët e ekuipazhit të mjetit në lidhje me karakteristikat e rrezikut të mallrave të rrezikshme, sipas shenjave dhe masat që duhen marrë sipas rrethanave mbizotëruese | | |
|--|---|--|
| Etiketat dhe tabelat e rrezikut | Karakteristikat e rrezikut | Udhëzuesi shtesë |
| (1) | (2) | (3) |
|  Lëndë të rrezikshme për mjedisin | Rrezik për mjedisin uJOR ose sistemin e ujërave të zeza | |
|  Lëndë me temperaturë të ngritur | Rrezik djegieje nga nxehtësia | Të shmanget kontakti me pjesët e nxehta të njësisë transportuese dhe me lëndët e rrjedhura |

ANEKSI X PAJISJET PËR FIKJEN E ZJARRIT

1. Tabela si vijon tregon dispozitat minimale për fikset e zjarrit të transferueshme për klasat e ndezshmërisë A, B dhe C që zbatohen te njësitë e transportit që mbartin mallra të rrezikshme, me përjashtim të atyre të përmendura në pikën 8.1.4.2 të ADR-së ose në pikën 2 të këtij aneksi.

| (1) Njësia e transportit me masë maksimale të lejuar | (2) Numri minimal i fikseve të zjarrit | (3) Kapaciteti i përgjithshëm minimal për njësi transporti | (4) Fikse e zjarrit e përshtatshme për zjarrin në motor ose në kabinë | (5) Kërkesa për fikse (t) e zjarrit shtesë. Të paktën një fikse zjarri do të ketë një kapacitet minimal prej: |
|--|---|---|--|--|
| ≤ 3.5 tonë | 2 | 4 kg | 2 kg | 2 kg |
| > 3.5 tonë ≤ 7.5 tonë | 2 | 8 kg | 2 kg | 6 kg |
| > 7.5 tonë | 2 | 12 kg | 2 kg | 6 kg |
| Kapacitet janë për pajisje me pudër të thatë (ose një kapacitet të njëjtë për çdo agjent tjetër, shuarës të përshtatshëm). | | | | |



2. Njësinë e transportit që transportojnë mallra të rrezikshme në përputhje me pikën 1.1.3.6 duhet të pajisen me një fikse zjarri të tranferueshme për klasat e ndezshmërisë A, B dhe C, me kapacitet minimal prej 2 kg pudër të thatë (ose me kapacitet të njëjtë për çdo agjent tjetër shuarës të përshtatshëm).

3. Fikset e zjarrit të tranferueshme, që përdoren për pikat 1 dhe 2 të këtij aneksi ose në pikat 8.1.4.1 ose 8.1.4.2 duhet të jenë të vulosura për të vërtetuar se ato nuk janë përdorur.

4. Gjithashtu, këto pajisje duhet të kenë shënimin e përputhjes me një standard të njohur nga një autoriteti përgjegjës i caktuar për këtë qëllim dhe mbishkrimin që tregon të paktën datën (muajin, vitin) e inspektimit tjetër të radhës ose të periudhës maksimale të lejuar të përdorimit, sipas rastit.

5. Pajisjet fikse të zjarrit duhet të instalohen në njësitë e transportit në mënyrë të tillë që të përdoren lehtësisht nga personeli i mjetit. Instalimi duhet të kryhet në mënyrë të tillë që zjarrfikëset të mbrohen ndaj agjentëve atmosferikë, me qëllim që të mos ndikojnë në sigurinë e tyre funksionale.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 10.7.2013
Doli nga shtypi më 10.7.2013

| | |
|--|------------------|
| | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 46 lekë